PËRMBAJTJA

Lajme 2
Milazim Krasniqi: Kujt i përngjet ish-hotel Unioni? 3
Gëzim Qerimi: Sfidat e Universitetit acarojnë raportet Qeveri-Rektorat 4-5
Intervistë me Miftar Ajdinin.............................. 6-8
Berat Dakaj: Avangardizmi I AAK-së, i AKR-së dhe i LDD-së 9
Sead Ujkani:Vazhdon të thellohet kriza socio-ekonomike 10
Fatos Shala: Celularomania................................ 11
Avni Avdiu: Fenomeni Gruevski...................... 12-13
Ferid Selimi: Decentralizimi i pushtetit në baza etnike – sfidë për Kosovën 14-15
Florije Ademi: Rihapja e gjykatave në veri, hap drejt funksionimit normal të drejtësisë 16-17
Emine A. Vezaj: Religjioni dhe viktimat e sugjestibilitetit psikik te shqiptarët.............................. 18-19
Demir Reshiti: Beogradi "riaktualizon" Kosovën .. 20-21
Muhamed Jusufi-Kajolli: Personalitetet më të njohura të Mekës.. 22-23
B. Sejdiu: Djaloshi që premton shumë 24
Osman D. Gashi: Fituesit e çmimit Nobel për 2008-tën .. 25
Agron Islami: Shumë shoqata, pak aktivitet! ... 26-27
Mimoza Sinani: Bumerang 2 (tregim)............ 28-29
Flamur Maloku: Struktura neutrale e tekstit... 30-31
Besim R. Cengu: Një kujtim dhe një bisedë me poetin antologjik.. 32-33
Fitim Veliu: Rrëfimi i gjyshes.............................. 33
Poezi 34
Ditëlind Reshiti: Kuriozitete................................ 35
Batjar Halili: Zhvillimi gjuhësor i fëmijëve nga 0-2 vjeç.. 36-37
Artan N. Bejta: Depresioni-sëmundje e botës moderne... 38-39
Fjalëkryqi 40


3 Kujt i përngjet ish-hoteli Unioni?


6 Intervistë me Miftar Ajdinin


14 Decentralizimi në baza etnike...


30 Struktura neutrale e tekstit


36 Zhvillimi gjuhesor i fëmijëve...



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti III / Nr. 22
19 tetor - 19 nëntor 2008
Botues
Zëri Ynë
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com

Redaktor përgjegjës
Demir RESHITI
demireshiti@hotmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmaloku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore
Mimoza SINANI

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14, përballë teatrit Dodona, Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

Nju Jork

8 tetor 2008

Pavarësia e Kosovës do të përballet me drejtësinë ndërkombëtare



Asambleja e Përgjithshme e OKB-së e ka miratuar rezolutën e paraqitur nga Serbia për të kërkuar mendim këshillues nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës, nëse ajo është ose jo në pajtim me ligjin ndërkombëtar. 77 vende anëtare të OKB-së kanë votuar për, 74 kanë abstenuar, ndërsa 6 kanë qenë kundër.
Beogradi ka thënë se këshilla neutrale juridike do të ndihmojë në uljen e tensioneve në rajon, por përkrahësit e Kosovës thonë se ajo do të ngadalësojë integrimin e Prishtinës në komunitetin botëror.
Edhe pse rezoluta serbe është miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, shumë nga 27 vendet anëtare të BE-së kanë abstenuar.
Pritet që të kalojnë dy deri në tre vjet derisa Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në Hagë ta japë opinionin e saj.

Podgoricë / Shkup



Mali i Zi dhe Maqedonia njohën Kosovën

Qeveria e Malit të Zi dhe ajo e Maqedonisë e kanë njohur shtetin e Kosovës në të njëjtën ditë.
"Qeveria ka vendosur njëzëri ta njohë Republikën e Kosovës" - u ka thënë gazetarëve ministri i Jashtëm i Malit të Zi, pas një takimi të qeverisë, duke shtuar se vendi i tij do të vë marrëdhënie të plota diplomatike me Kosovën fqinje.
Ndërkaq, vendimin për njohje të shtetit të Kosovës nga Maqedonia, e ka bërë të ditur ministri i jashtëm i këtij vendi, Antonio Milloshovski, i cili ka thënë se vendimi është në funksion të thellimit të bashkëpunimit midis dy vendeve.
Paraprakisht, Kuvendi i Maqedonisë me 85 vota për, 16 të përmbajtura dhe vetëm me 1 votë kundër, i ka dhënë dritë jeshile Qeverisë që ta njohë pavarësinë e Kosovës. Deputetët i kanë thënë 'po' rezolutës së paraqitur nga deputetët shqiptarë të partive në pushtet dhe atyre në opozitë.

Prishtinë

10 tetor 2008

Nis dhënia e letërnjoftimeve të Republikës së Kosovës



Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës, zyrtarisht ka filluar lëshimin e letërnjoftimeve të Republikës së Kosovës.
Në një ceremoni të organizuar në Kuvendin komunal të Prishtinës ku ishin të pranishëm ministri i Punëve të Brendshme, Zenun Pajaziti, ministri i Kulturës Rinisë dhe Sporteve, Valton Beqiri, kryetari i Komunës së Prishtinës, Isa Mustafa, si dhe përfaqësues të ambasadave amerikane e zvicerane në Prishtinë dhe përfaqësues të EULEX-it e UNMIK-ut, me letërnjoftime të reja u janë pajisur Divina Filipoviç, Gëzim Bajrami, Snezhana Gaqiç, Kemajl Kurteshi, Ivana Milenkoviç, Armend Nuredini, Arjeta Emra, Naim Hajdari dhe Qëndrim Jashari.

Kujt i përngjet ish-hotel Unioni?



Milazim KRASNIQI

Godina e ish hotelit "Union", prej kohës që komunarët ia kanë zbuluar krejtësisht pjesën e prapme, më ngjason me një dhi në siklet ngaqë nuk arrin të mbulojë me bishtin cubel pjesën e turpshme të sajën. E vetmuar në mes të katër rrugëve, e ekspozuar para mijëra syve kureshtarë e provokues, ajo ka mbetur ashtu për ibret. Kur ishin përreth saj dyqanet e vogla, miniargjendaria, berberhania (ku jam nënqethur për herë të parë si "prishtinali", në vitin 1970), shitorja e pjesëve elektrike e deri te pizzeria e Arbnor Morinës, pjesa e prapme nuk i dukej fare. Ndërsa, pjesa e përparme (edhe pse bash ajo është turpi i vërtetë i saj), dukej goxha e madhe, e krekosur dhe bile e fisme. Ajo kishte aty nja dy surrate të gravuara, si shenja të një mbretërie të përdalë, e cila i kishte rehatuar aty në mes të sheshit ata kopilë, pa pikë turpi, që po e përkundte në një djep të huaj.

Me arkitektin austriak, me pare të serbit, në zemër të tokës shqiptare, ishte ngritur ajo ndërtesë, që të përjetësonte triumfin dhe fuqinë e pasardhësve të car Llazarit. Ata ishin kthyer si hakmarrës, për humbjen që u ishte shkaktuar nga osmanët (e jo shqiptarët e shkretë) në vitin 1389 dhe kishin vulosur triumfin e vet gjakatar edhe me këtë godinë në zemër të Prishtinës. Nuk e di a e kanë bërë inaugurimin e saj me pogaçe e me kripë, sikundër bëjnë serbët në raste festash, por e di se ai truall është ujitur me gjakun e mijëra shqiptarëve, të cilët të vetmin faj e kanë pasur që kanë jetuar në shtëpitë e veta dhe kanë mbajtur në kokë plisa të bardhë. Por gjaku nuk bëhet ujë, thotë një fjalë. Prandaj, edhe nuk qe e thënë që ajo godinë dhe Kosova vetë të mbetej ashtu si e patën menduar pasardhësit e Llazarit. Erdhi një kohë kur ajo ndërtesë mori emrin "Skenderbeg". Për entuziazmin e asaj kohe, e mbaj mend një detaj nga rrëfimi i Namanit, një prishtinasi të vjetër, rahmet pastë. Ai më ka treguar se në "ditët e Shipnisë", gjatë një mitingu patriotik në platonë e "Skenderbegut", kur kishte ardhur Mustafa Kruja, një burrë tërë kohën ulërinte " Shkupi yni!", "Shkupi yni!" E veçanta e atij burri ishte se i kishte të dyja duart të gjymta dhe nuk arrinte të duartrokiste, meqë i kishte shuplakat të kthyera mbrapshtë. Por, ai nga entuziazmi patriotik, u mëshonte duarve së prapthi dhe bërtiste "Shkupi yni!', "Shkupi yni!", me një zë që ngrihej mbi të gjitha buçimat dhe ulërimat e tjera patriotike të asaj dite. Me dhjetëra herë Namani ma ka treguar këtë ngjarje dhe asnjëherë nuk ka harruar të tregojë konkretisht si i përplaste duart ai burri sakat dhe se si zëri i tij ishte më i thekshmi dhe më i larti në gjithë turmën. (Zoti na ka njoftuar se zëri më i keq është zëri i gomarit.) As Namani dhe askush tjetër nuk e di emrin e atij njeriu të përvëluar nga marazi patriotik për Shkupin, edhe pse ai atë ditë kishte qenë violina e parë e mitingut atdhetar, që kërkonte Shkupin t'i bashkohej "Shqipërisë mëmë". Pra, "Shqipërisë mëmë", e cila vetë ishte futur në përqafimin epshor të Italisë fashiste. Afërmendsh, iluzionin e tij dhe të mijëra të tjerëve, në krye me Mustafa Krujën, do ta ketë përlarë kasaphana e re që u shfaq në të mbaruar të Luftës së Dytë Botërore. Ëndrrat shqiptaromëdha të kohës së Luftës së Dytë Botërore, u shkallmuan tërësisht, kur serbët u kthyen sërish si hakmarrës dhe e shndërruan vendin sërish në një kasaphanë. Namani më ka treguar se si menjëherë pas "çlirimit", patrullat partizane hynin nëpër shtëpitë shqiptare dhe merrnin burrat e i fusnin në burgun e improvizuar, në ndërtesën ku më vonë do të ngrihej "Rilindja". Por pa i mbajtur gjatë aty, i shpinin në Tauk Bahqe dhe i pushkatonin. Vendi ku i pushkatonin këta shqiptarë fatmjerë, quhej Strelishte (as sot nuk ka emër shqip për atë vend, falë Zotit.) Kur kishte shkuar te burgu për t'i dërguar ca ushqime axhës së vet, Zeqirit, të cilin e kishin arrestuar një ditë më parë, policët i kishin thënë Namanit t'i kthente gjërat në shtëpi, sepse Zeqirit nuk i duheshin më. Sot e atë ditë nuk janë gjetur eshtrat e tij. Sipas asaj që kam arritur ta kuptojë nga rrëfimet e gjata të Namanit, shumica e të pushkatuarve, kanë qenë të zgjedhur si "nacionalistë shqiptarë", si puna e atyre demonstruesve të zjarrtë që kërkonin Shkupin t'i bashkohej Shqipërisë Etnike, në përqafimin epshor të Italisë fashiste. Por, kishin triumfuar komunistët dhe e kishin bërë shkrumb edhe tokën nën këmbë, e jo vetëm nacionalistët gjaknxehtë. E tëra ishte bërë në emër të proletariatit botëror. Edhe të proletarëve shqiptarë, në krye me shokun Enver Hoxha.

Për hir të kësaj historie të bujshme paradoksesh, besoj se tubimi në njëqind vjetorin e lindjes së Enver Hoxhës, është dashtë të mbahej në ndërtesën e ish Hotelit "Union", e jo në Sallën e Kuqe, ndonëse emri i kësaj të fundit i përshtatet atij aktiviteti të zjarrtë të enveristëve kosovarë. Po të mbahej tubimi për Enverin në atë godinë ose para saj, ashtu do të ishin të gjithë në të njëjtin vend, në faqet e një historie plot paradokse. Me sa kam dëgjuar, një kohë ajo godinë ka qenë pak edhe shtëpi publike. Ndërsa, mua më mbetet peng vetëm pse nuk arritën edhe një grupim artistësh të futeshin brenda asaj ndërtese dhe aty të miklonin muz(t) at e tyre. Promovimi i pseudovlerave të tyre do t'ia vente kapakun kësaj historie paradoksesh, në godinën dhe rreth godinës së ish hotel Unionit. E tëra ka nevojë për një kapak hermetik, që të mos kundërmojë më shumë. Atëherë do të arrihej ajo që thonë se ka thënë Shaban Polluxha: "Ma m.. nuk bahet".

P.S. Megjithatë, nuk është faji i godinës së ish hotel Unionit, që një pjesë e madhe e historisë sonë të vjetër e të re, i përngjet pamjes së pasme të dhisë, me bishtin përpjetë e me hallatet përfushë. Në të vërtetë, vetë ndërtesa e ish hotel Unionit i përngjet kësaj pjese të shënuar të historisë sonë. ■

Sfidat e Universitetit acaroj



Gëzim QERIMI

Pavarësia financiare është njëri ndër kushtet e shumta për reformat që parashihen me Procesin e Bolonjës. Me këtë vendim, UP-ja do të jetë e përafërt me universitetet moderne që ofrojnë dije, shkencë dhe u përgjigjen nevojave të shoqërisë dhe vendeve në shoqëritë e hapura.

Viti 2009 do të shënojë edhe fillimin e vetëfinancimit të UP-së. Ky vendim i Qeverisë duket se ka zbutur pak tensionet e krijuara mes saj dhe Rektoratit. Pavarësia financiare është njëri ndër kushtet e shumta për reformat që parashihen me Procesin e Bolonjës. Me këtë vendim UP-ja do të jetë e përafërt me universitetet moderne që ofrojnë dije, shkencë dhe u përgjigjen nevojave të shoqërisë dhe vendeve në shoqëritë e hapura.

Këtu do të ketë balancë mes fakulteteve me më shumë studentë dhe atyre me më pak studentë, në mënyrë që aktorët kryesorë në menaxhimin e mjeteve të jenë vetë fakultetet. Por, numri i madh i studentëve dhe mungesa e stafit akademik mund të sjellin vazhdimësinë e ftohjeve të reja në marrëdhëniet mes UP-së dhe Qeverisë.

Pas diskutimeve që kanë pasur, zyrtarët e Rektoratit dhe të Qeverisë kanë ardhur në përfundimin që UP-në ta bëjmë organizatë me vijë të veçantë buxhetore, që të menaxhojë vetë me mjetet vetjake dhe nëpërmes kësaj të rritet cilësia në punën mësimore dhe shkencore, të thellohen reformat në universitet dhe të jenë plotësisht në përputhje me trendët e zhvillimit universitar modern.

Futja e programeve studimore që përputhen me nevojat e ekonomisë është domosdoshmëri

Vlen te theksohet se një ditë para se të merrej ky vendim, kryeministri Thaçi kishte thirrur në një takim dekanët dhe përfaqësuesit e Rektoratit. Mirëpo, dikush nga strukturat e UP-së nuk e kishte mbështetur këtë vendim dhe një pjesë e tyre, ndër ta edhe rektori Enver Hasani, nuk i janë përgjigjur ftesës së kryeministrit. Ndërsa njeriu i parë i qeverisë, mospjesëmarrjes se tyre ju është përgjigjur me këtë fjalor: "Jam i vetëdijshëm se mund të ketë ndonjë perceptim tjetër të mentalitetit të vjetër, apo edhe arsye objektive të interesit të ngushtë në ndonjë hallkë të menaxhimit të Universitetit, por këto nuk do të mund ta pengojnë implementimin e këtij vendimi".

Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Enver Hoxhaj lidhur me problemet e fundit Qeveri-Rektorat, sidomos lidhur me kontekstin e rritjes së numrit të studentëve, ka potencuar disa herë se vendimi i ekzekutivit është objektiv që ka për synim rritjen e numrit të të rinjve në UP dhe ngritjen e cilësisë në arsim. Sipas MASHT-it, qëllimi i tyre si ministri dhe si qeveri është që ta rrisim pjesëmarrjen e të rinjve në arsimin e lartë, meqë Kosova është një vend që karakterizohet me shoqërinë më të re në Evropë. Më e rëndësishme për UP-në është të ofrojë një shumëllojshmëri të degëve dhe programeve në studim që përputhen me nevojat e ekonomisë, e në këtë trend të rritet edhe numri i studentëve në ato drejtime, por edhe i profesorëve. Vlen te ceket se qëllimi i reformave të Bolonjës është që të ketë dinamikë, që koha e studimeve të jetë shumë më e shkurtër. Formula e financimit të universiteteve të Prishtinës deri më tani ka qenë një proces shumë kompleks,



...në raportet Qeveri-Rektorat

por MASHT-i, së bashku me Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave, gjatë tre muajve të ardhshëm do të hartojnë një doracak se si të bëhet formula e financimit të UP-së dhe si të përdoren këto të holla.

Profesorët në UP nuk e preferojnë shumë konkurrencën

Edhe ata studentë të talentuar që kanë provuar të konkurrojnë për asistentë, shumë shpejt janë demoralizuar për shkak të parregullsive të shumta që ndodhin gjatë përzgjedhjes se tyre, si dhe për kushtet jo të mira që ofron Universiteti i Prishtinës për asistentët e vet. Profesorët në UP nuk e preferojnë shumë konkurrencën. Konkursi i fundit për pranimin e stafit të ri akademik në UP ka treguar më së miri se si u bëhet presion studentëve dhe profesorëve të rinj që mos të konkurrojnë.

Sfida kryesore e UP-së: kuadrot dhe numri i madh i studentëve

Pos problemeve të cekura më lart, që e sfidojnë çdo ditë e më shumë UP-në, problem në vete është çështja e kuadrove në universitetin e vetëm publik të Republikës së Kosovës, e cila mbetet sfida më e madhe për ta tejkaluar në mënyrë sa më të suksesshme.

Në këtë kontekst vlen të ceket se pas përfundimit të studimeve në Kosovë dhe fitimit të gradave shkencore jashtë vendit, të paktë janë ata që kthehen të ligjërojnë në UP. Edhe ata studentë të talentuar që kanë provuar të konkurrojnë për asistentë, shumë shpejt janë demoralizuar për shkak të parregullsive të shumta që ndodhin gjatë përzgjedhjes se tyre, si dhe për kushtet jo të mira që ofron Universiteti i Prishtinës për asistentët e vet. Profesorët në UP nuk e preferojnë shumë konkurrencën. Konkursi i fundit për pranimin e stafit të ri akademik në UP ka treguar më së miri se si u bëhet presion studentëve dhe profesorëve të rinj që mos të konkurrojnë.

Qëndrimi i Qeverisë së Republikës se Kosovës për shtyrjen e kohës së pensionimit të profesorëve të UP-së në 70 vjeç, i ka shtuar edhe disa rrudha fytyrës, edhe ashtu të vjetër të UP-së. Mungesa e kuadrove nuk shërohet me një ligj të tillë, të panatyrshëm dhe të paprecedent, por me përtëritje normale të gjeneratave të reja të cilat janë shkolluar në universitetet me renome botërore.

Vlen te theksohet se gjenerata e këtyre profesorëve është zhvilluar në një sistem krejt tjetër dhe disa nga ta mund të jenë pengesë për reformimin e UP-së. Absolutisht nuk bën të thuhet se njerëzit që janë të shtyrë në moshë nuk mund t'u përshtatën reformave, mirëpo është fakt që një gjeneratë e cila thjesht është zhvilluar në një sistem tjetër, natyrshëm që edhe mund të jetë pengesë në drejtimin e reformave të sistemuara në sistemin e ri.

Megjithëkëtë, nevoja për staf akademik në UP është shumë e madhe. Në mungesë të kuadrove të reja, deri diku mund edhe të arsyetohet vendimi i fundit i MASHT-it rreth shtyrjes së pensionimit të ligjëruesve në Universitetin e Prishtinës. Mirëpo dashtë Zoti qe kjo të jetë një zgjidhje e përkohshme, e cila do të jetë në fuqi deri atëherë kur gjeneratat e reja mund t'i gëzojnë ato vende.

Universiteti i Prishtinës, si kurrë më parë, ka nevojë për staf të ri akademik, pasi numri i studentëve në këtë vit akademik 2008-2009 është mbi 11 mijë studentë. ■



Intervistë me z. Miftar Ajdini, koordinator i paraleles së Medresesë "Alauddin" në Prizren

15 vjet punë e suksesshme

- **Interesimi për t'u regjistruar në medrese është gjithnjë e më i madh**
- **Sivjet është regjistruar gjenerata e 15-të e djemve dhe gjenerata e 10-të e vajzave**
- **Më të dalluarit në testin e maturës**
- **Objekti i ri shkollor ndër më bashkëkohorët në Kosovë**



Miftar Ajdini është i lindur në vitin 1956, në fshatin Zgatar të komunës së Sharrit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse shkollën e mesme pesëvjeçare në Medresenë "Alauddin" në Prishtinë. Fakultetin Filozofik, grupi i Gjuhës dhe Letërsisë Arabe e ka kryer në Benghazi të Libisë, gjatë viteve 1977-1981.
Në vitin 1983 punësohet si kryeimam i Këshillit të Bashkësisë Islame në Prizren.
Që nga hapja e paraleles së Medresesë "Alauddin" në Prizren emërohet arsimtar për lëndën e Gjuhës Arabe dhe Koordinator.
Gjatë viteve 1990-1994, ka qenë kryetar i Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës.
Është edhe përkthyes gjyqësor për gjuhë arabe i autorizuar nga Gjykata e Qarkut në Prizren.

Intervistoi: Demir RESHITI

Paralelja e ndarë fizike në Prizren e medresesë "Alauddin", sivjet shënon 15 vjetorin e punës së suksesshme. Shkolla renditet ndër vatrat më të suksesshme arsimore jo vetëm në regjionin e Prizrenit por edhe më gjerë. Vitin e kaluar, maturantët e kësaj shkolle kanë qenë më të dalluarit në testin e maturës duke e plotësuar atë rreth 80 për qind! Për të mësuar më për së afërmi për historikun, punën dhe aktivitetin e kësaj vatre arsimore, zhvilluam një intervistë me koordinatorin Miftar Ajdini.

PAQJA: ***A mund të na jepni një historik të shkurtër të punës së paraleles së Medresesë së mesme "Alauddin" në Prizren?***

Ajdini: Paralelja e medresesë në Prizren e ka filluar punën më 1 shtator të vitit 1993. Hapja e kësaj paraleleje në Prizren ka qenë imperativ i kohës. Nevoja e madhe për kuadro dhe pamundësia e pranimit në Medresenë e Prishtinës të numrit të nevojshëm ka bërë që organet kompetente të hapin këtë paralele.

Katër vite më vonë, gjegjësisht më 1 shtator të vitit 1997, është hapur edhe paralelja për vajza e cila fillimisht ka punuar pranë xhamisë "Terxhuman Iskender", më pas është zhvendosur në ndërtesën e Xhamisë së vjetër në Kurillë, kurse që nga viti i kaluar kemi kaluar në objektin e ri në Terzi Mëhallë.

Interesimi për t'u regjistruar në medrese është gjithnjë e më i madh

PAQJA: ***A ka interesim të mjaftueshëm të nxënësve për regjistrim në këtë shkollë?***

Ajdini: Interesimi për regjistrim, mund të thuhet se është variabil, herë më i mirë e herë më i dobët, por i mjaftueshëm sipas kapacitetit që kemi. Mund të them se viteve të fundit është shtuar interesimi sidomos te vajzat. Shkollimi zgjat katër vite. Pranohet për çdo vit nga një paralele (klasë) me nga 32-35 nxënës, si te djemtë ashtu edhe te vajzat.

PAQJA: ***Çka ka ndikuar sipas mendimit tuaj në rritjen e interesimit për t'u regjistruar në këtë shkollë?***

Ajdini: Cilësia e punës, angazhimi maksimal i stafit profesional, rezultatet që kanë arritur në shkollimin e mëtejshëm gjeneratat e mëhershme të dala nga ky institucion arsimor, etj., janë vetëm disa nga shkaktarët që kanë ndikuar në rritjen e interesimit për të vijuar mësimet në këtë shkollë. Mund të them se këtu i tërë stafi është i angazhuar me përkushtim në punën edukativo-arsimore. Disiplina është në nivel e gjithashtu edhe kushtet e punës. Të gjitha këto e shndërrojnë Medresenë në një vatër arsimore joshëse për gjeneratat e reja.

PAQJA: ***Nga cilat rajone vijnë nxënësit në këtë Medrese?***

Ajdini: Kryesisht nga qyteti Prizrenit me rrethinë, por edhe nga komunat Sharr, Therandë, Rahovec dhe Malishevë. Kur është kërkesa e madhe, drejtoria merr vendim për pranim edhe nga komunat e tjera, sidomos kjo ka ndodhur me vajzat, kur kemi pranuar nga Gjilani, Vitia, Ferizaj, Besiana etj.

PAQJA: ***A keni nxënës edhe nga vendet e tjera jashtë Kosovës dhe cilat janë kriteret e pranimit të tyre?***

Ajdini: Po. Kemi një numër simbolik që vijnë nga Shqipëria dhe Maqedonia, si djem ashtu edhe vajza. Të njëjtat kritere të pranimit deri më tani kanë vlejtur edhe për nxënësit jashtë Kosovës, pra, në radhë të parë merret parasysh suksesi i arritur në shkollimin paraprak.

Sivjet është regjistruar gjenerata e 15-të e djemve dhe gjenerata e 10-të e vajzave

PAQJA: ***A mund të na jepni ndonjë statistikë të përafërt sa është numri i të diplomuarve në Medresenë e Prizrenit që nga fillimi i punës së saj?***

me edukative e arsimore

Ajdini: Te djemtë deri më tani kanë diplomuar 11 gjenerata, ndërsa te vajzat gjashtë.

Shprehur në shifra, deri më tani janë diplomuar gjithsej 376 nxënës prej të cilëve 227 djem dhe 149 vajza.

PAQJA: ***Sa nxënës aktualisht ndjekin mësimet?***

Ajdini: Sivjet është regjistruar gjenerata e 15-të e djemve dhe gjenerata e 10-të e vajzave. Në të katër vitet e shkollimit, numri i vajzave është më i madh (134), kundrejt 98 djemve. Pra gjithsej i kemi 232 nxënës. Në vitin e parë janë 35 djem dhe 41 vajza, në të dytin 19 djem dhe 33 vajza, në të tretin 28 djem dhe 33 vajza dhe në vitin e katërt 16 djem e 27 vajza. Duhet theksuar se në vitin 1998, si pasojë e gjendjes së luftës në Kosovë, numri i vajzave të interesuara për t'u regjistruar në medrese ka qenë tepër i vogël, kështu që atë vit nuk është hapur fare paralelja e femrave. Pas çlirimit të Kosovës, interesimi për t'u regjistruar në medrese ka ardhur duke u rritur, veçmas te vajzat. Sivjet, siç e thash edhe më sipër, janë pranuar 41 vajza të përzgjedhura nga një numër dukshëm më i madh i kandidateve të interesuara.

PAQJA: ***Çka ndodh me nxënësit që e kryejnë Medresenë? Ku mund të vazhdojnë shkollimin?***

Ajdini: Ata pas diplomimit mund të vazhdojnë çdo fakultet që dëshirojnë, si brenda vendit ashtu dhe jashtë. Numri më i madh i ish-nxënësve tanë kanë kryer me sukses fakultete të ndryshme si në vend ashtu edhe jashtë (Egjipt, Turqi, Austri, Malajzi, Bosnjë e Hercegovinë, etj.) Një pjesë e tyre tani edhe janë kthyer të punojnë si profesorë në medrese.

PAQJA: ***A keni personel të mjaftueshëm arsimor dhe a janë me kualifikime përkatëse?***

Ajdini: I gjithë personeli është me kualifikim përkatës (superior). Lëndet jofetare i mbajnë profesorë nga shkollat e tjera. Pranimin e tyre e bën drejtoria. Kuadri pjesërisht paguhet nga MASHT-i, ndërsa pjesa tjetër nga buxheti i Bashkësisë Islame. Në paralelen e vajzave janë të angazhuara edhe profesoresha të lëndëve të ndryshme.

PAQJA: ***Theksuat se një pjesë e kuadrit paguhet nga Ministria e Arsimit. Na thoni çfarë raportesh keni me këtë ministri dhe a vlejnë për shkollën tuaj reformat që janë bërë kohëve të fundit në sistemin arsimor në Kosovë?***

Ajdini: Praktikisht medreseja është shkollë e mesme dhe ka të njëjtin status me të gjitha shkollat e mesme në vend. Vlen të theksohet se prej vitit të kaluar edhe nxënësit e Medresesë i nënshtrohen të njëjtit testit të maturës që e organizon MASHT-i, njëkohësisht me nxënësit e gjimnazit të përgjithshëm.

Më të dalluarit në testin e maturës

PAQJA: ***Çfarë lëndësh mësimore zhvillohen krahas atyre fetare?***

Ajdini: Përveç lëndëve fetare si Kur'an, Akaid, Fikh, Etikë islame, Shkenca kur'anore, Shkenca e hadithit, Tefsir dhe Hadith..., mësohen edhe lëndët tjera të drejtimit të përgjithshëm si Histori, Biologji, Kimi, Fizikë, Matematikë, Informatikë, Gjeografi, Psikologji, Sociologji dhe Edukatë fizike. Ndërsa nga gjuhët, krahas gjuhës amtare shqipe, mësohet edhe gjuha angleze, arabe dhe turke. Gjuha shqipe ka prioritet për nga numri i orëve dhe bashkë me gjuhën angleze dhe matematikën mësohen në të katër vitet. Po ashtu, në këto tri lëndë, nxënësit i nënshtrohen testit të maturës bashkë me nxënësit e gjimnazit të përgjithshëm.

PAQJA: ***Kur jemi te testi i maturës, a mund të na jepni ndonjë përqindje të kalueshmërisë së këtij testi nga ana e nxënësve të shkollës suaj?***

Ajdini: Nxënësit tanë kanë dalë ndër më të suksesshmit në nivel komunal, por edhe në nivel të republikës. Vlerësohet se arritshmëria e nxënësve tanë është rreth 80%, që kur krahasohet me mesataren në nivel vendi është gati përgjysmë më e lartë.

Objekti i ri shkollor ndër më bashkëkohorët në Kosovë

PAQJA: ***Si qëndron puna me objektet shkollore. A keni hapësirë të mjaftueshme dhe kushte për punë?***

Ajdini: Objekti i ri i ndërtuar prapa xhamisë së Terzi mëhallës, në të cilin aktualisht mësojnë vajzat, ka hapësirë të mjaftueshme dhe kushte ideale për mësim. Objekti ende nuk është i për-





funduar tërësisht. Punimet janë në fazën përfundimtare...

Janë katër dhoma mësimi për djem dhe katër për vajza, ndërsa kabineti informativ, biblioteka, mensa dhe amfiteatri janë të përbashkëta dhe do të shfrytëzohen me orar të caktuar nga të dy gjinitë.

PAQJA: ***Kush ka ndihmuar në ndërtimin e objektit shkollor?***

Ajdini: Kanë ndihmuar donatorë të ndryshëm. Në ndërtimin e këtij objekti nuk kanë marrë pjesë as drejtoria e Medresesë, as Bashkësia Islame e Kosovës e as Ministria e arsimit, por është një investim i donatorëve kryesisht të jashtëm. Fillimisht e kanë nisur disa individë, kurse tash së fundi është inkuadruar Organizata Qeveritare TIKA nga Turqia, e cila një pjesë të madhe të punimeve ia ka kontraktuar ndërmarrjes ndërtimore "Getoari" nga Prizreni, të cilët janë duke i kryer punimet përfundimtare, dhe shpresojmë se në semestrin e dytë të këtij viti shkollor, të sjellim në objektin e ri edhe djemtë.

PAQJA: ***Në kuadër të medresesë funksionojnë edhe konviktet. Sa është kapaciteti i këtyre konvikteve dhe çfarë kushtesh u ofroni nxënësve konviktorë?***

Ajdini: Kemi dy konvikte, një për djem dhe një për vajza. Ai i djemve ka filluar vitin e kaluar, kurse konvikti i vajzave ka filluar këtë vit. Kapaciteti i konviktit të djemve është 40 vende ndërsa në konviktin e vajzave të paraparë për 50 vende, për shkak të interesimit të madh është tejkaluar numri dhe tani aty i kemi të sistemuara 60 vajza. Kushtet janë shumë të volitshme. Për momentin, vajzat konviktore marrin vetëm nga një shujtë ushqimore, ndërsa me fillimin e punës së mensës, që shpresojmë të ndodhë shumë shpejt, atëherë do të marrin edhe nga një shujtë të ngrohtë.

PAQJA: ***Kush ka përparësi për vendosjen në konvikt dhe çfarë kriteresh përdoren për përzgjedhjen e nxënësve që do të banojnë aty?***

Ajdini: Përparësi sigurisht kanë nxënësit që vijnë nga komunat e tjera, pra kriteri kryesor për pranim është largësia. Nxënësit paguajnë një shumë simbolike për fjetje dhe ushqim. Duhet theksuar se nxënësit që vijnë nga familjet e varfra, që marrin ndihma sociale, janë të liruar nga pagesa.

PAQJA: ***Çfarë aktivitetesh të tjera zhvillohen krahas mësimit?***

Ajdini: Nxënësit janë mjaft aktivë. Edhe pse deri më tani nuk kemi pasur kushte të volitshme, prapëseprapë janë gjetur forma për organizimin e aktiviteteve të lira. Nxënësit tanë janë angazhuar si në aktivitete sportive ashtu edhe në aktivitete kulturore e të ngjashme. Funksionon grupi letrar në kuadër të së cilit botohet revista "Besimi" ku nxënësit publikojnë punimet e tyre. Është aktiv gjithashtu edhe kori i nxënësve te dy degët, edhe te vajzat edhe te djemtë, i cili paraqitet me programe (ilahi) me rastin e festave të ndryshme fetare.

PAQJA: ***Çfarë bashkëpunimi keni me shkollat e tjera në qytetin e Prizrenit?***

Ajdini: Raportet i kemi shumë të mira, për vetë faktin se këtu janë të angazhuar një numër i konsiderueshëm i personelit arsimor që vijnë pothuajse nga të gjitha shkollat e mesme të Prizrenit.

PAQJA: ***Çfarë marrëdhëniesh keni me drejtorinë komunale të arsimit?***

Ajdini: Marrëdhëniet janë kryesisht të mira. Ato zhvillohen në dy linja, sepse ne fizikisht ekzistojmë dhe veprojmë në Prizren, por i takojmë drejtorisë së arsimit të Prishtinës, sepse kjo është paralele e ndarë e medresesë "Alauddin" të Prishtinës. Mirëpo për shkaqe praktike, në raste të caktuara bashkëpunojmë edhe me drejtorinë e arsimit në Prizren, si bie fjala me rastin e organizimit të provimeve të maturës, etj.


PAQJA: ***Në fund, cili do të ishte mesazhi juaj për lexuesit e revistës "Paqja"?***

Ajdini: Kam shumë respekt për stafin që e boton këtë revistë. Ju falënderoj për punën e madhe që po bëni. Lus zotin që t'iu shpërblejë. Ju dëshiroj punë të mbarë dhe sukses në të ardhmen. Do të kishte qenë mirë që revista "Paqja" të na ofrohet me një numër më të madh ekzemplarësh, si në shkollën amë në Prishtinë ashtu edhe në paralelet e ndara në Prizren dhe Gjilan, sepse mendoj se nxënësit vërtet kanë ç'të lexojnë në këtë revistë. ■



Pa panik

Avangardizmi i AAK-së, i AKR-së dhe i LDD-së



Berat DAKAJ

Eugene Ionesco, në një shkrim të tijin për termin e avangardës (term ushtarak), gjendjen e njeriut avangard e shihte të tillë: *"Njeriu i avangardës është si armiku brenda fortesës, rënien e të cilës e do tmerrësisht, kundër të cilës ngre krye..."*. E ngjashme me këtë gjendje të armikut është avangardizmi (protesta) i kësaj treshe opozitare, e cila rrjedh prej formës qeverisëse të pushtetit të Thaçit, nga dikush (qytetarët) e vlerësuar qeveri e punës, nga disa të tjerë (protestues opozitarë) qeveri e dështimeve. Pranohet edhe njëra edhe tjetra!

Të tria këto parti, pas zgjedhjeve, ende pa u formuar qeveria, sigurisht ju kujtohet, i serviloheshin fituesit, Thaçit. Bënin deklarata shumë të buta, ishin shumë të matura, përkrahnin programet e partisë së Thaçit, ishin të gatshme të bënin koalicion me PDK-në, madje, mund të pranonin çfarëdolloj pozite që ua ofronte ajo. Kurse programet që kishin përgatitur për qeverisje partitë kandiduese/ofertuese, për çudi, ishin shumë të ngjashme me ato të PDK-së, si në nivel qendror, po ashtu edhe në atë komunal. Ta merrte mendja, sipas deklaratave të përfaqësuesve të partive e udhëheqësve të tyre, se programet e të gjitha partive i ka shkruar vetëm një grup njerëzish. Por, u bë ç'u bë, të gjitha përftesat ledhatake të AAK-së, të AKR-së, të LDD-së u hodhën poshtë pas formimit të qeverisë nga, dikur armiket më të mëdha, PDK-ja dhe LDK-ja. E nga këtu filloi edhe toni agresiv i partive të mbetura opozitë, ndaj jo koalicionit por PDK-së. Të gjithë ata që nuk kishin arritur marrëveshje me PDK-në e mohuan koalicionin e tashëm qeverisës, duke e parë atë shumë të dëmshëm për Kosovën (ende nuk qe shpallur pavarësia).

Së këndejmi, ky lloj avangardizmi, i cili përbëhet nga këto parti të vogla, e që kërkojnë ndryshime, ka tejkaluar "skenën teatrore" (lojën) të tyre. Tash nëpërmjet tij (avangardizmit), që është veprim dhe shprehje e vjetëruar, që rrënon e i bën keq tjetrit që të fitojë vetë (veprim i arsyeshëm politik, por jo teologjik e njerëzor/demokratik), thuren "mite", si: *gjashtëmuajshi i kësaj qeverie është llugë; kësaj qeverie gjithçka po i shkon mbrapsht; qeveri vetëm e asfaltit* (lavdërojnë Limajn) *dhe e shkollave* (dhe Hoxhajn); *qeveri e dështimeve;* e bomba të tjera hidhen çdo ditë në *fortesën* (kujtoj shprehjen e Ionescos) e Qeverisë së Kosovës.

Opozita nuk duhet të ketë kësi qëllimi. Ajo nuk duhet që nëpërmjet kësi lloj fjalësh ta sulmojë qeverinë. Assesi! U tha se ky është veprim i vonuar, mit i zhveshur, i pafunksion, të cilit (dështimit të saj) nuk i beson më kush. Njerëzit kanë prirje të gjykojnë dhe të vlerësojnë. Ka disa që mjet më të fuqishëm të sulmit kanë gjuhën (taktikë diplomatike), të tjerët, atyre që iu mungon kjo taktikë sa diplomatike e letrare, është shumë e natyrshme, krekosen me gjoks e grushte (taktikë fizike). Sido që të jetë, qëllimi i avangardistëve është të rrënojnë, t'i paraprijnë - qoftë të mirës, qoftë të keqes, prandaj edhe veprojnë - qoftë diplomatikisht, qoftë fizikisht!!! ■

Vazhdon të thellohet kriza socio-ekonomike

Zhvillimi ekonomik i vendit është identifikuar si brenga kryesore e qytetarëve pas shpalljes së pavarësisë, prandaj, në këtë drejtim, ky preokupim duhet të jetë edhe prioritet i të gjitha instancave relevante vendore, në mënyrë që vendi të shkojë përpara drejt prosperitetit dhe stabilizimit afatgjatë.



Sead UJKANI

Kriza sociale dhe ekonomike, e karakterizuar me rritje të papunësisë dhe varfërisë, që e ka përshkuar Kosovën viteve të fundit vetëm sa është thelluar duke mos u veçuar me ndonjë ndryshim të theksuar. Kaluan tetë muaj nga pavarësimi i vendit tonë dhe nuk po vërehet asnjë shenjë e stabilizimit ekonomik të vendit. Kaluan tetë muaj nën hijen e një agjende diplomatike jo shumë të frytshme të qeverisë së Kosovës, tetë muaj të mbushur plot e përplot me deklarata të shumta të zyrtarëve të vendit tonë për lulëzim dhe zhvillim të vendit.


"Riinvest": Kosova karakterizohet nga parametra shqetësues ekonomikë...

Kriza ekonomike dhe sociale po thellohet dhe vendi ynë vazhdon rrugëtimin fatkeq drejt stagnimit ekonomik i cili mund të ketë si efekt pasoja të shumta dhe të padëshirueshme për situatën e gjithmbarshme në vend.

Treguesit e fundit lidhur me gjendjen socio-ekonomike në vend paralajmërojnë një gjendje shqetësuese. Sipas këtyre treguesve, vazhdon trendi relativisht i ulët i rritjes ekonomike, i përcjellë me një bilanc negativ tregtar. Edhe më tej, vendi ynë vazhdon të karakterizohet nga një deficit i lartë tregtar dhe natyrisht ajo që është për t'u brengosur në tërë këtë gjendje, është fakti se numri i të papunëve dhe varfëria shkojnë drejt shtimit të vazhdueshëm.

Në raportin e fundit kërkimor, lidhur me situatën socio-ekonomike në vendin tonë, të publikuar gjatë këtij muaji nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore "Riinvest", theksohet se vendi ynë vazhdon të karakterizohet nga parametra shqetësues ekonomikë që po reflektohen direkt në thellimin e krizës ekonomike dhe sociale në vend. Nga sa u tha më lart, nuk ka ndonjë ndryshim të kësaj situate, përveç rritjes së inflacionit, që ka ndikuar në rënien e fuqisë blerëse të konsumatorëve dhe ngecjes së problemit të privatizimit që vetëm sa i kontribuojnë edhe më shumë rëndimit të mëtejshëm të gjendjes socio-ekonomike.

Përfundimisht, duhet të ketë lëvizje në këtë drejtim, para se të ballafaqohemi më ndonjë situatë të palakmueshme për të gjithë ne, meqë pakënaqësia për këtë gjendje është duke u rritur vazhdimisht.



Zhvillimi ekonomik i vendit është identifikuar si brenga kryesore e qytetarëve pas shpalljes së pavarësisë, prandaj, në këtë drejtim, ky preokupim duhet të jetë edhe prioritet i të gjitha instancave relevante vendore në mënyrë që vendi të shkojë përpara drejt prosperitetit dhe stabilizimit afatgjatë. Promovimi i investimeve të huaja, si dhe me theks të veçantë intensifikimi i përpjekjeve për krijimin e një ambienti të mirëfilltë për zhvillimin e sektorit privat, do të ishte shumë domethënës duke ditur efektin e këtyre dy elementeve në tërë procesin e stabilizimit afatgjatë, të qëndrueshëm dhe kontinuozë të Republikës së Kosovës. ■

UNDP: Papunësia dhe varfëria paraqesin problemet më të rëndësishme me të cilat po përballet Kosova

Në publikimin e fundit të bërë nga UNDP-ja, përkatësisht në raportin e 22-të me radhë të Paralajmërimit të Hershëm për Kosovën, theksohet se papunësia dhe varfëria paraqesin problemet më të rëndësishme me të cilat po përballet vendi ynë, ndërkohë që preokupimi kryesor i qytetarëve, tanimë pas pavarësimit të vendit, është bërë zhvillimi ekonomik i tij. Ajo çka bie në sy në këtë publikim është se numri i atyre që deklarojnë gatishmërinë për t'ju bashkangjitur protestave publike, lidhur me gjendjen e tanishme socio-ekonomike në vend, vazhdon të jetë ende i lartë.



Celularomania - dukuri shqetësuese nëpër shkolla

Fuqia ligjore e Ministrisë së Arsimit është vetëm një urdhër i lëshuar më 17 maj 2007 për ndalimin e celularëve në orët e mësimit. Zbatimi i këtij urdhri, siç pohohet edhe nga vetë zyrtarët e MASHT-it, është tepër i vështirë.



Fatos SHALA

Sapo mbaron ora e mësimit, një mish-mash zilesh dëgjohet në klasë. Kush e kush të vërë në pah telefonin e tij dhe meloditë e rralla që ai ka. Askush nuk mund ta ndalojë përdorimin e tyre në orën e pushimit, por në 45 minutat e orës së mësimit telefonat duhet të jenë të fikur. Mësuesit e shkollave të mesme janë më të ndjeshëm ndaj këtij fenomeni. Ata shprehen të shqetësuar se nxënësit e shkollave të mesme janë tepër të varur nga përdorimi i telefonave të lëvizshëm. Madje orët e mësimit rrezikohen seriozisht nga celularomania.

"Nxënësit në shkollën tonë më lehtë blejnë celular se sa libra. Ka nxënës te ne që nuk ka asnjë libër, por telefonin e ka të teknologjisë së fundit" - thotë Miftar Haxhiu mësues në shkollën fillore "Faik Konica".

Çfarë thotë ligji?

Mendimi i punonjësve arsimorë, por edhe i Ministrisë së Arsimit, është që prania e këtyre aparateve në orët e mësimit, prej kohësh, përbën një shqetësim të madh.

Fuqia ligjore e Ministrisë së Arsimit është vetëm një urdhër i lëshuar më 17 maj 2007, për ndalimin e celularëve në orët e mësimit. Zbatimi i këtij urdhri, siç pohohet edhe nga vetë zyrtarët e MASHT-it, është tepër i vështirë.

Kjo dukuri nuk lejon mbarëvajtjen e rregullt të orës së mësimit dhe ndikon në vëmendjen e nxënësve, jo vetëm të atyre që përdorin celularët, por edhe për nxënësit e tjerë, pohojnë burime zyrtare të Ministrisë së Arsimit.

E rëndësishme është që ky udhëzim të mos mbetet si një relikt tradicional mbi tavolinat e drejtuesve të shkollave, por të ndiqet zbatimi i tij në kushtet e një celularomanie të shfrenuar, sidomos në shkollat e kryeqytetit.

Provimi në klasë kalohet shumë thjesht me anën e një celulari, mjafton që zgjidhja të përcillet me një mesazh të shkurtër, ose edhe me një foto. Mësuesit shpeshherë janë të kujdesshëm dhe vigjilentë në rastet e provimeve, qoftë atyre në fund të semestrit, apo edhe testimeve të herëpashershme.

E çfarë nuk has në një klasë gjimnazi: celularë me kamera, me aksesorë të veçantë, me ngjyra të ndryshme, me forma të çuditshme, me parametra teknologjie të kohës së fundit, celularë-kompjuter. "Kam marrë telefonin e babit sot se i imi u prish. E luta të ma jepte, meqë kishim dy orët e fundit një aktivitet jashtëshkollor dhe duhet ta njoftoja që të vinte të më merrte" - thotë Besarta, 15-vjeçare nga Prishtina.

Mësues të ndryshëm thonë se ka edhe nxënës që edhe pse me zor i blejnë librat, apo nuk kanë kurrfarë interesi për shkollën, nuk heqin dorë nga modelet e fundit dhe shumë të shtrenjta të celularëve. Ide dhe zgjidhje të ndryshme qarkullojnë por deri më sot pa ndonjë rezultat. ■

Korrespodencë nga Shkupi

Fenomeni

Nikolla Gruevski nuk është vetëm kryeministër i Maqedonisë. Për më tepër, ai është një fenomen ballkanik të cilin shqiptarët me naivitetin e tyre politik po e ngrenë gjithnjë e më lart.




Avni AVDIU

Nikolla Gruevski nuk është vetëm kryeministër i Maqedonisë. Për më tepër, ai është një fenomen ballkanik të cilin shqiptarët me naivitetin e tyre politik po e ngrenë gjithnjë e më lart. Rejtingu i këtij politikani brenda partisë së tij është ngritur më shumë për shkak të prirjeve të tij ekonomike sesa politike. Kështu që pakkush do të kishte menduar se Gruevski një ditë do të 'shkëlqente' më shumë politikisht se sa ekonomikisht. Duke luajtur me kartën nacionaliste, ai ka e matur mirë pulsin e popullatës shumicë për ta kthyer mllefin e cenimit të dinjitetit kombëtar në eufori politike. Loja taktike në bisedimet me palën greke lidhur me kontestin e emrit i shkon për leverdi karrierës së tij. Pikërisht për këtë, zvarritja e kësaj çështje, ndonëse e dëmton shtetin në të gjitha aspektet, si duket atij për momentin i konvenon. Dallimet dhe përplasjet e tij me presidentin, lidhur me këtë çështje, vetëm sa ia forcojnë pozicionin, gjë që duket qartë nga sondazhet e fundit.

Defaktorizimi i subjekteve partiake shqiptare...

Mirëpo kryeministri Gruevski ka bërë diçka më shumë që të konsiderohet fenomen. Ai arriti që, si askush më parë para tij, të luajë jo vetëm me faktorin politik shqiptar, por edhe me gjithë shqiptarët. Fillimisht i defaktorizoi subjektet partiake shqiptare, duke luajtur me ta me grepin e pushtetit. Në këtë lojë të gjitha partitë politike shqiptare, pa përjashtim, u treguan më të trullosura se peshqit. Kjo dëshmon se ata nuk kanë ofertë serioze për popullin dhe këtë boshllëk idesh përpiqen ta mbushin me retorikë populiste dhe me demagogji, duke e kamufluar mashtrimin e tyre politik si taktikë e strategji. Ndërkaq Gruevski duke i lënë të gjitha në rehatinë e vetëmashtrimit vazhdon të sillet me to si fëmija me kukullën. Zaten s'mund të jetë ndryshe funksioni i partnerit qeveritar të koalicionit, sepse qëllimi i Gruevskit qysh herët ishte veçmë i qartë: 'dua shumicën në parlament që të mos kushtëzohem nga partitë shqiptare'. Dhe tashmë kur shihet se kjo është arritur, atëherë loja vazhdon dhe do të vazhdojë… Gruevski, me përpikëri, është përkushtuar të realizojë programin 'Rilindja në 100 hapa', duke mbajtur qëndrim kategorik lidhur me emrin, duke i stimuluar nënat maqedonase të lindin nga tre fëmijë e më tepër (përmes ligjit të njëanshëm të natalitetit), duke subvencionuar bujqit në Maqedoninë Lindore, e kështu me radhë. Në të njëjtën kohë, kryeministri maqedonas tregoi kokëfortësi në mosnjohjen e Kosovës, voton ligje antishqiptare brenda natës, angazhohet për avancimin e statusit të ish-luftëtarëve maqedonas të 2001-shit, e për ish-luftëtarët shqiptarë me bekimin e BDI-së përgatit procese gjyqësore, duke shkelur kështu, me një lehtësi të padurueshme paturpësie, edhe ligjin e amnistisë së miratuar nga vetë parlamenti. BDI-së nuk i mbetet gjë tjetër veç se të jetë një miratuese e heshtur, një dëgjuese e nënshtruar dhe një spektatore e sikletshme. Kjo parti votat i fitoi në saje të premtimeve të mëdha, por dita-ditës, nga ato premtime nuk po mbetet asgjë përpos zhgënjimit. BDI-ja gjatë fushatës parazgjedhore u prononcua përmes zëdhënëses se kjo parti po të hynte në qeveri si fituese e zgjedhjeve do të bënte që qeveria ta njihte pavarësinë e Kosovës në ditën e dytë pas formimit të qeverisë. Tre muaj pas konstituimit të qeverisë, nënkryetari i qeverisë nga radhët e BDI-së (Ademi) bëri të njëjtin gabim që kishte bërë më



Gruevski



parë kur ishte në pushtet PDSH-ja (Thaçi), duke theksuar se njohja do të ndodhë kur ata do ta vlerësojnë një gjë të tillë. Në këtë pikë, loja e Gruevskit njëmend ishte shumë cinike, sepse ai e trajtoi këtë çështje si provokim ndaj ndjenjave jo vetëm të shqiptarëve, por edhe të faktorit ndërkombëtar. Në momentin kur parlamenti malazez i sugjeroi qeverisë së Malit të Zi njohjen e Kosovës dhe kur qeveria e Podgoricës e bëri publike këtë njohje, ngurrimi i Maqedonisë ishte i padurueshëm. Prandaj parlamentit dhe qeverisë maqedonase nuk i mbeti alternativë. Më në fund e hodhi peshqirin në ring me hir a me pahir, me dëshirën a jo të qeveritarëve maqedonas. Njohja e pavarësisë së Kosovës ndodhi me vonesë dhe zvarritja, ndonëse bëhej me pretekstin se lidhej me interesat e vendit, prapëseprapë ishte thjesht e paarsyeshme. Atë mund ta duronin vetëm se ata, të cilët të magjepsur me pushtetin, shpreheshin se bashkëqeverisja e partnerëve të koalicionit po përjetonte çastet më idilike dhe se gjithçka ishte në rregull. Por shqiptarët e Maqedonisë, që nga koha e 'prosperitetit', janë mësuar t'u thonë 'gjithçka në rregull' pikërisht atyre që nuk rregullojnë asgjë.

Njohja e pavarësisë së Kosovës nuk është meritë e asnjë partie ose politikani shqiptar, por e presionit ndërkombëtar

Njohjen e pavarësisë s'mund ta pengonte askush, madje as vetë politikanët maqedonas sado që deshën ta prolongonin. Mirëpo ishte e pandershme nga politikanët shqiptarë përpjekja për t'u vetëfaktorizuar me këtë çështje të ndjeshme. Ata i ngjanin gomarit të fabulës, të cilin ndonëse po e hante ujku thoshte 'inshalla jam në ëndërr'. Përndryshe ata duhet ta kenë të qartë se njohja e pavarësisë së Kosovës nuk është meritë e asnjë partie ose politikani shqiptar, por e presionit ndërkombëtar (përkatësisht atij amerikan), sepse çështja nuk ishte a donte Thaçi a Ahmeti ose Gruevski, por ashtu e kërkonte situata gjeopolitike dhe gjeostrategjike. Nga ana tjetër, individët dhe partitë politike duhet të vetëdijesohen: se ata ndonëse duan të vetëfaktorizohen, faktikisht janë defaktorizuar. Ata nuk i pyeste kush, lëre më për njohjen e Kosovës, por nuk i pyet as për gjëra më elementare. Tekefundit, a e pyet fëmija kukullën: 'a po do të luajmë tani, apo jo?'.

Në agjendë nuk janë kërkesat e shqiptarëve, por dëshirat e Gruevskit

Loja është në duar të Gruevskit. Tani për tani shqiptarët atë e kanë ngritur mbi ligjin, mbi shtetin, mbi gjithçka: ai ka pushtet absolut. Politikanët shqiptarë, siç e kanë sjellë punën, mund të jenë vetëm shërbëtorë të tij. E shërbëtori i ndihmon padronit vetëm për t'i realizuar planet e tij. Zaten, deri më tani, nuk dihet se çfarë roli tjetër kanë, kur kihet parasysh se para syve të tyre po pengohet zbatimi i Marrëveshjes të famshme të Ohrit, bashkimi i komunave shqiptare të Kërçovës, po zvarritet zgjidhja adekuate e çështjes së gjuhës, flamurit etj.etj.

Tekefundit, në agjendë nuk janë kërkesat e shqiptarëve, por dëshirat e Gruevskit. Ai gëzon përkrahje nga BDI-ja dhe bile është afërmendsh të ndryshojë edhe kushtetutën vetëm e vetëm për të zgjedhur nga radhët e tij edhe presidentin e ardhshëm të vendit. Flitet se ai do të jetë Boshkovski i liruar si i pafajshëm nga gjykata e Hagës për rastin e Lubotenit. Edhe kjo mund të ndodhë dhe për këtë askush nuk duhet të çuditet. Gruevski, hap pas hapi, do ta arrijë 100-shin e premtuar gjatë fushatës parazgjedhore. Mirëpo çfarë do të arrijë BDI-ja e Ali Ahmetit mbetet t'ia lëmë më mirë kohës, edhe pse shenjat nuk janë fare premtuese. Në vrap janë 'Akili' dhe 'breshka'. Sipas teorisë së Zenonit breshka do të arrijë më shpejtë. Megjithatë tani për tani po shihet vetëm vrapi i 'Akilit maqedonas', ndërsa 'breshka' është duke u sjellë në inercion rreth boshtit të vet…hapat e saj nuk duken… ajo është habitur duke shikuar hapat e 'Akilit'. Këtë veprim 'breshka' e mendon si taktikë e strategji, me gjasë për ta bërë ndonjë akrobacion befasues. Megjithatë, siç janë duke ecur punët, Gruevski ka gjasa të shndërrohet në një figurë emblematike maqedonase, si fenomen që e ka në dorë llozin e Arkimedit për Maqedoninë, edhe pse shkëlqimi i tij i tanishëm shikuar në një plan afatgjatë përcillet nga një hije zvetënuese. ■



Ferid SELIMI

Decentralizimi baza etnike - sfi

Decentralizimi si proces është funksional, kur mënyra e ndërtimit të tij është e pranueshme dhe e përshtatshme për shoqërinë, si edhe nuk është e ndarë në vija etnike. Çdo përpjekje tjetër, që do të thotë ndarje në baza etnike, do të ishte e imponuar politikisht dhe do të humbiste kuptimin që ka në të vërtetë. Ajo që po tentohet të bëhet në Kosovë (bazuar në Dokumentin e Ahtisarit) është një decentralizim politiko-etnik, territorial dhe i pjesshëm.


Qeverisja, në terminologjinë gjuhësore dhe politiko-juridike, ka të bëjë me drejtimin e veprimtarive politike administrative të një shteti, duke ushtruar pushtetin ekzekutiv e urdhërdhënës. Me këtë nënkuptohet se qeverisja ka të bëjë me të gjitha format e administrimit, ose thënë ndryshe me drejtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me ushtrimin e pushtetit urdhërdhënës dhe ekzekutues. Ndërkaq, qeverisja territoriale paraqet një proces shumë të përbërë që shprehet në më shumë funksione, mbi bazën e dy parimeve: centralizimit dhe decentralizimit të pushtetit. Kur i zbërthejmë këto dy nocione duhet qartësuar se në rastin e parë kemi të bëjmë me grumbullimin e pushtetit në një qendër (në majë të piramidës), ku urdhrat dhe vendimet merren dhe jepen nga lart, që do të thotë nga qendra. Decentralizimi, në anën tjetër, është e kundërta e centralizimit dhe ka të bëjë me dobësimin e ndikimit të qendrës në pjesët e saj.

Qeverisja vendore merret me drejtimin dhe menaxhimin e të gjitha veprimtarive që janë në kompetencë të njësive të qeverisjes vendore, përkatësisht komunave, e që nuk janë të rezervuara për ndonjë pushtet tjetër. Në hierarkinë e urdhrave, qeverisja vendore, gjendet poshtë pushtetit qendror në mënyrë vertikale, meqë, qeverisja vendore është një institucion që veprimtarinë e vet politike, ekonomike, zhvillimore dhe shërbyese e shtrin në një zonë të përcaktuar territorialisht të një vendi. Funksioni i saj ka të bëjë me të gjitha veprimtaritë që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm të banorëve lokalë. Andaj, komuna kuptohet dhe cilësohet si njësi themelore territoriale e administrimit lokal të një vendi.

Roli i qeverisjes vendore në sistemin politik të një shteti duhet parë në radhë të parë në marrëdhëniet që ka me qeverinë e atij shteti. Kjo qeverisje ka për qëllim që të jetë një faktor i rëndësishëm dhe bazë mbi të cilën organizohen shërbimet për të plotësuar nevojat lokale. Si e tillë, qeverisja vendore mendohet të jetë në një partneritet me instancat më të larta demokratike të një shteti. Kjo do të thotë që ajo duhet të ketë marrëdhënie të mira dhe veprimtaria e saj duhet të jetë në kuadër të ligjeve që dalin nga pushteti qendror siç janë kushtetuta, ligji për qeverisje vendore etj. Nga pikëpamja administrative, ajo duhet parë si diçka racionale, pasi siguron kryerjen e efektshme të shërbimeve publike, aty ku ato janë të nevojshme nën drejtimin e qeverisjes qendrore.

Nisur nga fakti që reformat në qeverisje vendore janë ndër detyrat kryesore kushtuar transformimit të një shteti, koncepti i reformave duhet pranuar dhe parë si demokratizim dhe decentralizim i pushtetit dhe administratës shtetërore, duke i dhënë më shumë përgjegjësi qeverisjes vendore në kryerjen e punëve që i takojnë, përmirësimit të shërbimeve publike, (përfshirë këtu kualitetin e shërbimeve të ofruara qytetarëve si dhe interesimin e qytetarëve për të marrë pjesë në çështjet publike) që kanë të bëjnë me interesin e përgjithshëm të qytetarëve në procesin e administrimit.

Principet kryesore prej nga duhet nisur decentralizimi janë: demokratizimi dhe decentralizimi i administratës; autonomia e qeverisjes vendore nga qeveria; aktivitetet e pavarura brenda ligjit; zhvillimi i komunës dhe pronës private; përpilimi i buxhetit të pavarur të komunës



i i pushtetit në idë për Kosovën

dhe zgjedhja e metodave të udhëheqjes.

Kjo lë të kuptohet që decentralizimi jo vetëm që ka mënyrën e zbatimit të detyrave, por edhe vendosjen për ato. Kur marrim parasysh këto fakte do të shohim se decentralizimi ka anët pozitive dhe ato negative. Anët pozitive, apo përparësitë e këtij lloji të qeverisjes, janë të shumta e unë do të përmend disa nga më kryesoret:

E para: Bëhet shpërndarja e përgjegjësive në shumë shkallë;

E dyta: Qytetari është më afër shërbimit;

E treta: Rruga e komunikimit në raportin pushtet- qytetar bëhet më e shkurtër;

E katërta: Përshtaten kushtet dhe rrethanat e caktuara në një mjedis të caktuar; dhe

E pesta: Identifikimi i parregullsive është më i lehtë dhe përgjegjësia është individuale.

Sa u përket mangësive, nëpërmjet decentralizimit, paraqiten:

✎ Mungesa e kujdesit për interes më të gjerë;

✎ Theksohet interesi i pjesshëm; dhe

✎ Nuk funksionon sa duhet kontrolli.

Ky lloj decentralizimi është eksperimenti i parë në botë që hap shtigje për ndarje në baza etnike

Decentralizimi si proces është funksional, kur mënyra e ndërtimit të tij është e pranueshme dhe e përshtatshme për shoqërinë, si edhe nuk është e ndarë në vija etnike. Çdo përpjekje tjetër, që do të thotë ndarje në baza etnike, do të ishte e imponuar politikisht dhe do të humbiste kuptimin që ka në të vërtetë. Ajo që po tentohet të bëhet në Kosovë (bazuar në Dokumentin e Ahtisarit) është një decentralizim politiko-etnik, territorial dhe i pjesshëm. Kur konstatoj këtë, kam parasysh këto elemente:

Së pari: Decentralizimi nuk përfshin të gjitha komunat në Kosovë, por aty bëhet fjalë vetëm për ato rajone ku jetojnë pakica serbe (Mitrovicë, Graçanicë, Novo-Bërdë, Partesh, Shtërpcë, Leposaviq e Zubin Potok). Në të gjitha këto komuna ose vendbanime që po mëtojnë të bëhen komuna me shumicë serbe në Kosovë, si me dokumentin gjithëpërfshirës të Ahtisarit ashtu edhe me Ligjin për Qeverisje Lokale të Kosovës, u është dhënë e drejta e shkollimit të lartë dhe shëndetit dytësor. Kjo do të ishte krejt në rregull, kur këto kompetenca do t'u ishin dhënë edhe komunave të tjera me shumicë shqiptare. Andaj me të drejtë mund të konstatohet që ky lloj decentralizimi është eksperimenti i parë në botë që hap shtigje për ndarje në baza etnike.

Së dyti: Decentralizimi në Kosovë po legalizon enklavat me shumicë serbe e me të edhe lidhjen e tyre horizontale, jo vetëm mes vete, por edhe me Qeverinë e Republikës së Serbisë.

Së treti: Kosova dhe pushteti qendror i saj (që është i pjesshëm), nuk mund ta kontrollojë punën dhe veprimtarinë e këtyre komunave ngase jo vetëm që legalizojnë lidhjen horizontale me një shtet fqinj, por edhe lejojnë financimin (kanë të drejtën e asistencës financiare) nga Serbia.

Kur këto komuna financohen nga Serbia, me çfarë të drejte mund të kërkojë qeveria e Kosovës që ato të veprojnë në bazë të ligjit për qeverisje lokale të Republikës së Kosovës?!

Bazuar në këto që potencova dhe konstatova, mund të nxirret lirisht përfundimi se Kosova (edhe pse tani e pavarur) ende nuk e ka të centralizuar tërë pushtetin. Ende pushteti është i ndarë në tri vija horizontale: qeveria e Kosovës, UNMIK dhe EULEX. Derisa të mos bëhet, së pari, centralizimi i pushtetit në një qendër, (në këtë rast në duar të qeverisë së Kosovës) vështirë se do të mund të mbijetojë një decentralizim i tillë politiko-etnik, që shumicës shqiptare i imponohet nga burrështetasit a qeveritë e shteteve mike. ■

(Autori është magjistër i shkencave dhe është specializuar për qeverisjen vendore.)



"VETËVENDOSJA" KUNDËRSHTON KREUN E EULEX-IT

13.10.2008

Lëvizja "Vetëvendosje" ka organizuar një fushatë kundër kreut të misionit të EULEX-it, Yves de Kermabon.

Të prirë nga lideri i tyre, Albin Kurti, aktivistë të "Vetëvendosjes", nëpër qendër të Prishtinës kanë vendosur posterë nga ceremonia e ndërrimit të Komandës së KFOR-it në vjeshtën e vitit 2005, ku Kermabon shihej në shoqëri me Dragan Paskashin, komandantin e shtatmadhorisë së ish-Unionit Serbi dhe Mali i Zi.

Rihapja e gjykatav funksionimit nor



Florije ADEMI

Kthimi i punëtorëve të gjykatave dhe prokurorive në vendet e tyre të punës është paraparë të bëhet në tri faza. Faza e parë është kthimi i ndërkombëtarëve atje, e dyta kthimi i punëtorëve vendorë, atyre shqiptarë dhe serb, ndërkaq faza e tretë parasheh largimin e ndërkombëtarëve dhe funksionimin e gjykatave vetëm nga vendorët.

MITROVICË, TETOR

Pas shumë premtimeve të ndërkombëtarëve, në fillim të tetorit disa muaj pas një "pushimi të dhunshëm", janë rihapur objektet e judikaturës në veri të qytetit të Mitrovicës, të ndarë në baza etnike që nga mbarimi i luftës.

Një grup i përbërë nga katër punëtorë ndërkombëtarë janë kthyer në ndërtesat e Gjykatës së Qarkut dhe asaj Komunale, që shënon fillimin e fazës së parë të një plani për rivënien e tyre në funksion.

Baruti: Jam optimist se edhe ne punëtorët vendorë do të kthehemi në vendet tona të punës

Kryetari i Gjykatës së Qarkut, Kapllan Baruti, e vlerëson këtë si një hap përpara që shpie drejt normalizimit të funksionit të organeve të drejtësisë në veri të vendit.

Në një bisedë për revistën "Paqja", ai u shpreh optimist se në një të ardhme edhe punëtorët shqiptarë të këtyre institucioneve do të kthehen në objektet e tyre, aty ku punuan krahas provokimeve dhe vështirësive të ndryshme nga mbarimi i luftës, deri pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

"Jam optimist se edhe ne punëtorët vendorë do të kthehemi në vendet tona të punës, dhe optimizmin tim e bazoj në bisedat që kemi me vendorët dhe ndërkombëtarët. Qëllimi është funksionimi i organeve të drejtësisë edhe në atë pjesë të qytetit dhe s'kam pse mos t'u besoj institucioneve tona dhe atyre ndërkombëtare" - u shpreh Baruti.

Kthimi i punëtorëve të gjykatave dhe prokurorive në vendet e tyre të punës është paraparë të bëhet në tri faza. Faza e parë është kthimi i ndërkombëtarëve atje, e dyta kthimi i punëtorëve vendorë, atyre shqiptarë dhe serb, ndërkaq faza e tretë parasheh largimin e ndërkombëtarëve dhe funksionimin e gjykatave vetëm nga vendorët.

Faza e parë veç ka filluar, prokurorët çdo ditë pune po shkojnë në objektet e gjykatave dhe deri më tani nuk është shënuar ndonjë incident.

Baruti thotë se nuk kanë ndonjë afat të caktuar se kur do të fillojë implementimi i fazës së dytë, gjegjësisht rikthimi i punëtorëve vendorë atje, mirëpo shpreson se një ditë edhe kjo do të ndodhë.

Ivanko: Gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë do të merren vetëm me shqyrtimin e rasteve urgjente

Në anën tjetër, zëdhënësi i UNMIK-ut në Prishtinë, Alexander Ivanko, ka deklaruar se plani është që për 60 ditët e para, në gjykata, në veri, të punojnë vetëm gjykatës dhe prokurorë ndërkombëtarë dhe aktualisht është duke u biseduar me Prishtinën dhe Beogradin se kur mund të kthehen edhe gjykatësit vendorë atje. Sipas tij, gjykatësit dhe prokurorët ndërkombëtarë do të merren vetëm me shqyrtimin e rasteve urgjente.

"Do të jenë dy gjykatës dhe dy prokurorë ndërkombëtarë dhe rreth 12 oficerë dhe asistentë gjyqësorë e të tjerë. Këta do të merren kryesisht me rastet urgjente kriminale, por nuk do të merren me raste penale" - ka theksuar ai.

Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Bajram Rexhepi, vlerëson se rihapja e gjykatave është një hap pozitiv, ndonëse mendon se serbët e veriut të qytetit nuk do të pranojnë kthimin e gjyqtarëve serbë në to.

"Është paralajmëruar se, fillimisht, do të punohet sipas rregullores së UNMIK-ut, që nuk është mirë, por është më mirë sesa të mos funksionojnë fare këto institucione" - thekson ai.

Në ditën e rifunksionalizimit të Gjykatës së Qarkut dhe asaj Komunale, Policia e Kosovës ka shtuar masat e sigurisë, kryesisht rreth objektit të gjykatave.



Kapllan Baruti - Kryetar i Gjykatës së Qarkut

e në veri, hap drejt rmal të drejtësisë

Ndonëse në atë pjesë të qytetit janë ende prezent tensionet ndëretnike, situata e sigurisë konsiderohet relativisht e qetë.

Zëdhënësi rajonal i policisë së Kosovës në Mitrovicë, Besim Hoti, bën të ditur se policia i ka shtuar masat e sigurisë përreth objekteve të gjykatave, duke pasur për bazë ndjeshmërinë e këtij rasti dhe vlerësimet e marra nga terreni.

Kurse administratori rajonal i UNMIK-ut në Mitrovicë, Gerard Galluci, thotë se Kombet e Bashkuara e kanë marrë në mënyrë serioze punën e gjyqit, gjë që e tregon fakti i kthimit të punëtorëve ndërkombëtar atje. Me hapjen e gjyqit, ai beson se edhe policia mund ta zgjerojë aktivitetin e vet.

Shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt të këtij viti rezultoi me një varg protestash dhe rebelimesh të serbëve në veri të Mitrovicës, që kundërshtonin ashpër krijimin e shtetit të Kosovës.

Në kuadër të këtyre protestave u përfshi edhe Gjykata e Qarkut dhe ajo Komunale që ndodhen në veri të qytetit, punëtorët e se cilave pas uzurpimit të objekteve nga serbët dhe për shkaqe sigurie, u detyruan t'i ndërpresin punët.

Stafi lokal i gjykatës i zhvendosur në qytetin e Vushtrrisë

Që nga 20 shkurti i këtij viti, stafi lokal i gjykatës ishte zhvendosur në qytetin e Vushtrrisë, ku edhe sot shqyrton vetëm rastet urgjente.

Me 17 mars, objektet e organeve të judikaturës janë rikthyer nën kontroll të policisë së UNMIK-ut dhe pjesëtarëve të KFOR-it, pas marrjes me dhunë nga protestuesit serb tri ditë më parë, me ç'rast gjatë përleshjeve qe vrarë me armë zjarri një polic i UNMIK-ut, si dhe qenë plagosur dhjetëra policë të tjerë dhe pjesëtarë të KFOR-it. Atëkohë, administratori rajonal i Mitrovicës, Gerad Galluci, ka kritikuar qasjen e drejtuesve të UNMIK-ut në Prishtinë rreth intervenimit gjatë trazirave kur u serbët uzurpuan gjykatën në veri. Fatkeqësisht, ai edhe sot mbron qëndrimin e tij, duke barazuar policinë me kriminelët serbë.

Sipas tij, atë ditë secili që ka përdorur dhunën ka vepruar gabim dhe përdorimi i forcës nuk i ka ndihmuar askujt.

Vlen të theksohet se organet e judikaturës ishin të vetmet institucione kosovare që punuan në veriun e Kosovës që nga mbarimi i luftës. Gjatë këtyre viteve, punëtorët e këtyre organeve iu nënshtruan provokimeve dhe problemeve të shumta të shkaktuara nga serbët, por ata gjithherë ishin të vendosur të vazhdonin punën në objektet e tyre.

Ndonëse të gjithë punëtorët shqiptarë ishin banorë të një pjese tjetër të qytetit, fillimisht ata janë transportuar në gjykata me autoblinda nga KFOR-i, më pas me kamion, pas disa viteve me kombibus të blinduar të policisë dhe së fundi me autobus të një kompanie shqiptare, por që mbante tabela të regjistrimit të shtetit francez. ■



Religjioni dhe viktimat e sugje



Emine A. VEZAJ

Gjithandej, kur flitet për fenë islame në përgjithësi dhe për muslimanët në veçanti, thuren intriga e trillime diku të bazuara në "fakte", diku të pabaza, por diku edhe të shtrembëruara skajshmërisht. Jo larg nga kjo, lajmet e ditëve të fundit në disa media, thuajse ne muslimanëve na vetëdijesojnë për një studim me serioz rreth identiteti tone fetar.

Komunizmi ishte armiku i hapur e njeriut, ndërsa moderniteti është hipokrizi tinëzake. Religjioni thuajse çdo herë, si në të kaluarën ashtu edhe tani, është një ndër temat më të nxehta në çdo vend. A do të thotë kjo, se ana shpirtërore e njeriut është e pacenueshme, apo është ajo e cila preket më së shumti nga të gjithë? Religjioni ka zënë një vend të posaçëm ndër shqiptarët, ndoshta edhe për faktin se si i tillë është i lidhur drejtpërdrejtë edhe me identitetin e shqiptarëve.

Gjithandej, kur flitet për fenë islame në përgjithësi dhe për muslimanët në veçanti, thuren intriga e trillime diku të bazuara në "fakte", diku të pabaza, por diku edhe të shtrembëruara skajshmërisht. Jo larg nga kjo, lajmet e ditëve të fundit në disa media, thuajse ne muslimanëve na vetëdijesojnë për një studim me serioz rreth identiteti tone fetar.

Gazeta "Express" nganjëherë më duket arenë e atyre që shprehin pakënaqësitë ose edhe pozitën që duhet të ketë besimi në jetën e njeriut, e nganjëherë është gazeta më e shitur edhe për shkak të disa shkrimeve "skandaloze" që boton në lidhje me anën besimore të njeriut. Më kujtohet se kohë më parë në këtë gazetë përshkruhej xhehennemi dhe xhenneti në Medrese, tani jo shumë larg nga ajo kohë, në këtë medium bëhen publike edhe "viktimat e para religjioze të sugjestibilitetit psikik" të disa "muslimanëve" nga Drenica të cilët tashmë i janë bashkangjitur Atit të shenjtë - Papa Benediktit XVI dhe presin që ai të shlyejë mëkatet e tyre në të ardhmen.

Romani i Ben Blushit, më i përfoluri...

Siç kam thënë historia për disa është e errët, jo për hir të fakteve që kanë para vetes, por për shkak të miopisë që kanë. Kohëve të fundit, romani i Ben Blushit është bërë ndër romanet më të përfolur nga të gjithë. Nganjëherë më kujton edhe "Kodin e Da Vinçit" të Dan Brown-it, roman i cili u bë qendër e komenteve dhe analizave për shkak të nxjerrjes në pah të një realiteti pak më ndryshe ose pro et contra. Në këto kohë të turbullta, në të cilat është duke kaluar bota në përgjithësi, edhe ky na ishte mangët. Kristo Frashëri, historian i kohës, nuk le hamendësim te lexuesi se duhet të jetë kujtuar sadopak kur i ka vënë titullin analizës së këtij romani "Romani i Ben Blushit dhe vlerësimet e 'analistëve' që nuk e kanë lexuar". Kjo nuk është aspak çudi nga ana e tij, se vërtet kur nuk mendon siç mendojnë të gjithë, atëherë edhe rezultatet nuk janë të njëjta. Kristo e ka analizuar ashtu siç e ka analizuar dhe për këtë person nuk ka koment më tutje.

Komentet e bëra nga z. Kristo më kujtojnë edhe një herë anën sugjestive të propagandës kamufluese të punës që bëjnë të huajt për humbjen e identitetit fetar musliman të shqiptarëve. Më çudit shumë paraqitja e tij kur thotë se "pothuajse të gjithë u hallakatën në faktorët që përcaktuan përhapjen e Islamit ndër shqiptar... ata harrojnë se kemi të bëjmë me një vepër letrare dhe se autori i një vepre letrare ka liri të plotë të vendosë ngjarjet ku të dojë dhe personazhet si të dëshirojë". Në fjalët e tij, se romani në fjalë i Blushit është keqkuptuar dhe keqinterpretuar nga disa, (ngase ajo është e drejtë e tij që të shkruaj çka të dojë), bazohet edhe me disa vepra të tregimtarit frëng Jules Verne, ku përshkruhen disa udhëtime imagjinare, si shembull në tregimet e tij "Nga toka në hënë" ose "Rreth botës në 80 ditë" dhe sipas Kristos askush nuk e ka kritikuar autorin frëng në lidhje me atë që ka shkruar edhe pse të gjitha janë utopi të imagjinatës së tij. Në fjalën e tij, z Kristo, thotë se akoma është historian dhe se nuk ka për qëllim as ta mbrojë e as ta kritikojë brendinë e romanit të Blushit, pasi është një vepër letrare, por që sërish merr të drejtën dhe e analizon nga pikëpamja historike, mbase këtu është edhe poenta e studimit të tij, romani përpos letërsisë, trajton më shumë aspektet historike dhe identitetin e shqiptarëve.



Në anën tjetër, ne që jemi të njohur me rrethanat ndikuese në shoqëri rreth përpjekjeve të vazhdueshme të historianëve, letrarëve, e shumë figurave të tjera për të shtrembëruar gjurmët e asaj që ka qenë dhe është islame, do të mjaftoheshim sikur të sillnim edhe disa shembuj të asaj që mësohet si letërsi tek nxënësit shqiptarë.

Nxënësve në emër të veprave letrare u ofrohet literaturë me karakter fetar

Dr. Milazim Krasniqi, në librin e tij "E vërteta e islamit ndër shqiptarë" anën sugjestive nëpërmjet kësaj metode diktuese e sheh edhe në disa spektra të tjerë. Në librin e lartcekur, ai nuk lë pa përmendur edhe përpjekjet e disa in-

stibilitetit psikik te shqiptarët

telektualëve tanë për të shtrembëruar historinë dhe në veçanti zhdukjen e fesë islame si pjesë të identitetit shqiptar. Dr. Krasniqi, si specialist i letërsisë dhe si filolog që është, edhe më tutje garanton për atë që pohon dhe qëndron prapa saj. P.sh. ndër atë që disa e quajnë letërsi të mirëfilltë, e që sipas Dr. Krasniqit nuk është, janë edhe disa vepra letrare si "Meshari" i Gjon Buzukut, "Çeta e profetëve" e Pjetër Bogdanit ose edhe "Gjella e Shën Marisë së Virgjër" e Jul Varibovës, e që nxënësit tanë i mësojnë në klasën e nëntë ose në vitin e dytë të shkollës së mesme. Të gjitha këto nuk janë aspak letërsi e mirëfilltë, por janë kryekëput vepra me karakter fetar. Por, kjo e gjitha ka edhe "vlerën" e saj. Pra mësohen në një kohë kur formimi i identitetit është më lehtë të formësohet ose të shtrembërohet. Pra, është një moshë kur nxënësi nuk mund të dallojë vlerën estetike prej vlerës religjioze në letërsi. Ndërsa të gjithë ata që kanë shkruar letërsi të mirëfilltë shqiptare siç janë: Nezim Frakulla, Hasan Zyko Kamberi, Sylejman Neimi, Muhamet Kyçyku, Shahin Kolonja, si dhe shumë të tjerë, nuk janë fare në programet shkollore. Të tillët, vetëm e vetëm se kanë shkruar me alfabet arab, nuk janë të mirëseardhur në letërsinë "burimore", ashtu siç janë Gjon Buzuku, Pjetër Bogdani e të tjerë. Edhe ky roman nuk është aspak larg këtij realiteti. Ne besojmë që qëllimi është i kësaj natyre, pra është një deformim që ka për qëllim të rrënojë identitetin tonë islam.

Në anën tjetër, Kristo nuk mjaftohet sikur të mos përmendte edhe Nexhat Ibrahimin, studiuesin më objektiv të historisë fetare shqiptare në Ballkan. Sipas z. Kristos historia e Shqipërisë nuk është zbardhur me ndonjë punim shkencor, e që gjithnjë sipas tij: "tjetër është ta trajtosh historinë fetare të Shqipërisë në bazë të kritereve shkencore, dhe tjetër është të kesh opinione mbi historinë e feve... për përhapjen e fesë Islame në Shqipëri ende nuk ka një traktat shkencor shterues të mbështetur mbi burimet dokumentare historike...". Sipas tij studiuesit si Tomas Arnold, e Noel Malcolm, (që për fatin tonë të mbarë në këtë drejtim, ata nuk kanë qenë as shqiptarë, e as myslimanë), nuk janë asgjë.

Kristo Frashëri mbështetet në imagjinatën e Ben Blushit...

Ndër të tjera, nga fundi i tekstit, ai prek edhe çështjen e pranimit të Islamit ndër shqiptarë në periudhat e hershme. Gjithnjë sipas Kristos: "nuk mungojnë shkrime me pikëpamje mbi kohën kur filloi Islamizimi i shqiptarëve dhe arsyet e apostazisë së tyre nga krishterimi në Islam, por autorët e këtyre shkrimeve janë kufizuar vetëm me shfaqjen e pikëpamjeve, të gjykimeve apo të vlerësimeve, pa u mbështetur në burime dokumentare dhe pa u shoqëruar me argumente objektive, për këtë arsye ato mbeten pikëpamje dhe nuk hyjnë në fushën e historiografisë shkencore". Më poshtë në analizën e tij, ai përmend edhe "paragjykimet islamike".

Interesant për mua, si një historian i llojit të Kristos të mos mund të bëjë dallim mes paragjykimeve muslimane dhe atyre islame, madje siç thotë edhe z. Nexhat Ibrahimi, ai mund të kishte thënë paragjykimet e x historianit, por jo edhe paragjykimet islamike. Por, ç'të bëjmë ne, ende kemi kllapën e komunizmit, atë që ka nxjerrë breza të llojit të Kristos, që nuk shikon argumentet shkencore, por mbështet në imagjinatën e Ben Blushit.

Ky lloj sugjestibiliteti psikik tek shqiptarët zaten ka qenë edhe ndër mënyrat më të "qëlluara" për shtrembërimin e çdo ideologjie, jo vetëm në Ballkan me depërtimin e kulturave dhe ideologjive të ndryshme, por edhe më gjerë. Edhe sot e kësaj dite është duke u vepruar kësisoj, madje rasti i fundit i publikuar nga gazeta "Express" rreth konvertimit të disa "muslimanëve" në fenë e të "parëve" sikur akoma më shton bindjen se shkurtpamësia dhe neglizhenca e disa "muslimanëve" tanë ndaj fesë së tyre është rasti më i mirë që të "huajt" të gjejnë vendin e përshtatshëm për të shtrirë aktivitetin e tyre.

Në e-mailin që pranova nga z. Nexhat Ibrahimi në lidhje me rastin e Kristo Frashërit, ai përfundonte kështu: "Në tërë këtë të keqe, një gjë është pozitive: të tillët deri vonë na kanë injoruar. Reagimi i tyre publik tregon se pozicionet e tyre janë rrezikuar dhe ka ardhur koha që kjo faqe e historisë së rrejshme të hidhet në shporta". ■



Reflektime ndërkombëtare për Kosovën

Beogradi "riaktual


Demir RESHITI

Një shtet i vetëm (Samoa), e ka njohur shtetin e Kosovës gjatë muajit shtator. Ngjarjet e zhvilluara në Gjeorgji sikur e kanë nxjerrë Kosovën në plan të dytë të agjendës së qendrave vendimmarrëse. Për ta "riaktualizuar" Kosovën në arenën ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe, duket se është angazhuar Beogradi zyrtar i cili ka arritur që t'i bindë vendet anëtare të Këshillit të Sigurimit të OKB-së që në sesionin e 63-të të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara të debatohet për kërkesën e Serbisë për të marrë mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës. Ndërkohë, në raportin më të ri të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian, të publikuar më 8 shtator, kjo organizatë e ka vlerësuar gjendjen në Kosovë si të qëndrueshme. Nga ana tjetër, Grupi Ndërkombëtar i Krizave (GNK) në raportin më të ri të titulluar "Tranzicioni i brishtë i Kosovës", ka vlerësuar se komuniteti ndërkombëtar ka dështuar në përmbushjen e zotimeve dhe se perspektiva e një ndarjeje faktike po rritet...

Në vazhdim po paraqesim një kronologji të ngjarjeve dhe deklaratave më të rëndësishme lidhur me Kosovën, gjatë muajit shtator 2008.

(2 shtator) Sarkozy: Para njohjes së Kosovës, ka pasur diskutime

Bruksel - Presidenti francez, Nicolas Sarkozy, pas përfundimit të samitit të jashtëzakonshëm të Bashkimit Evropian, duke u shprehur për qëndrimin e Rusisë se "me Kosovën është bërë precedent", ka theksuar se para se disa shtete të Bashkimit Evropian ta njihnin pavarësinë e Kosovës, me vite të tëra janë zhvilluar diskutime në forumet ndërkombëtare. "Ka pasur ndërmjetësim të OKB-së dhe ia kam përkujtuar presidentit Medvedev se kur Evropa e ka pranuar Kosovën, Rusia e ka dënuar vendimin e Evropës", - ka thënë presidenti francez, vendi i të cilit kryeson presidencën e radhës së Bashkimit Evropian.



Lamberto Zanieri

(4 shtator) Zanier: OSBE do ketë rol më të madh

Bruksel - Rikonfigurimi i UNMIK-ut i jep mundësi OSBE-së që të ketë rol më konkret në Kosovë, ka thënë shefi i UNMIK-ut, Lamberto Zanieri para Këshillit të Përhershëm të OSBE-së. "Ndryshimet që prekin UNMIK-un paraqesin për OSBE-në edhe mundësi edhe sfidë; mundësi të mirë se do të jenë në vijën e frontit në kuptimin e monitorimit, këshillimit dhe të ngrenë zilen e alarmit atëherë kur duhet; si dhe sfidë sepse asnjëri nga ne nuk do të ketë autoritetin, që dikur kishte UNMIK-u," - ka thënë Zannier.

(5 shtator) Rice: Kosova dhe Gjeorgjia – dy situata të ndryshme

Lisbonë -Sekretarja amerikane e Shtetit, Condoleezza Rice, ka thënë se Kosova dhe Gjeorgjia janë dy situata të ndryshme. Këto komente ajo i bëri në konferencën për shtyp në Lisbonë, pas takimit me ministrin e Jashtëm të Portugalisë, Luis Amado. "Para së gjithash, Kosova ishte situatë unike, erdhi pas shkatërrimit të Jugosllavisë", - tha zonja Rice, duke shtuar se Kosova u bë e pavarur pas një procesi të zgjeruar.

osce

OSBE

(8 shtator) OSBE: Gjendja në Kosovë është stabile

Bruksel- 'Pavarësisht nga ndryshimet politike fundamentale në Kosovë gjatë gjysmës së parë të vitit 2008, gjendja politike dhe e sigurisë ka mbetur jashtëzakonisht stabile' - thuhet në raportin më të ri të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian, të publikuar më 8 shtator.

"Qeveria dhe Kuvendi kanë treguar pak mirëkuptim për rolin e mediave të lira dhe rëndësinë e pavarësisë së mediave nga ndërhyrja politike për zhvillimin e demokracisë së qëndrueshme", - thuhet mes tjerash në raportin vjetor të OSBE-së.

(9 shtator) Bildt: S'ka asnjë frikë nga planet serbe për Kosovën

Bruksel - "Nuk ka asnjë frikë" nga planet serbe për t'i kërkuar Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë të "japë mendimin" për pavarësinë e Kosovës, ka deklaruar Carl Bildt, ministër i Jashtëm i Suedisë. Pas takimit me ministrin e Jashtëm serb Vuk Jeremiç, Bildt tha se i ka thënë atij se përderisa dy vendet kanë dallime rreth statusit të Kosovës, ato mbështesin anëtarësimin e Serbisë në Bashkimin Evropian.



Gianfranco Fini

(15 shtator) Fini: Demokracia në Kosovë, test për BE-në

Tiranë – "Ndërtimi i një shteti demokratik në Kosovë përfaqëson shtrat, mbi të cilin do të matet jo vetëm autoriteti e besueshmëria e Bashkimit Evropian, por edhe besueshmëria e klasave qeverisëse të vendeve të Ballkanit

lizon" Kosovën

Perëndimor, për të qenë pjesë përbërëse e familjes së madhe evropiane", - ka deklaruar kryetari i Dhomës së deputetëve të Italisë, Gianfranco Fini. Ai i ka bërë këto komente gjatë një fjalimi para deputetëve të Parlamentit të Shqipërisë.



Samoa

(16 shtator) Samoa njohu Kosovën

Apia – 'Republika Samoa e ka njohur shtetin e Kosovës', - ka njoftuar mbrëmë Ministria e Jashtme e Kosovës.

Ky është një shtet në Paqësorin jugor, që pavarësinë nga Zelanda e Re e fitoi në vitin 1962. Samoa është shteti i 47 me radhë që e ka njohur Kosovën.

(18 shtator) Rasmussen: Serbia të mos pengojë EULEX-in

Prishtinë - Kryeministri i Danimarkës, Anders Fogh Rasmussen i ka bërë thirrje Serbisë që të lejojë vendosjen e misionit të Bashkimit Evropian, EULEX edhe në pjesët e banuara me serbë në Kosovë. Ai ka thënë se vështirësitë në dërgimin e misionit më të madh policor dhe të drejtësisë të BE-së janë "kryesisht për shkak të rezistencës serbe". Kryeministri i Danimarkës i bëri këto komente në Prishtinë, ku u takua me udhëheqësit e Kosovës.

(18 shtator) Sawers: Serbia po gabon lidhur me Kosovën

Nju Jork - Ambasadori i Britanisë në Kombet e Bashkuara John Sawers ka vlerësuar se Serbia po gabon që çështjen e ligjshmërisë së shpalljes së pavarësisë së Kosovës po e paraqet para Gjykatës Ndërkombëtare, sepse sipas tij kjo sjell rrezik për destabilizimin e Kosovës, gjë që nuk është në interes të askujt. "Mendojmë se serbët janë marrë në mënyrë të gabuar me faktin se e kanë futur këtë në rendin e ditës. Ata duan që të ndalin çështjen e Kosovës përkohësisht, por duke vazhduar ndërkohë procesin e integrimit në Bashkimin Evropian", - i ka thënë Sawers radios shtetërore britanike.

(19 shtator) Greqia njeh pasaportat e Kosovës

Prishtinë - Greqia ka vendosur t'i njohë pasaportat e Republikës së Kosovës, me gjithë faktin se akoma nuk ka marrë vendim për njohjen e shtetit. Ky vendim është bërë publik nga shefi i zyrës greke në Prishtinë, Dmitris Moschopoulos, pas takimit me kryeministrin e Kosovës, Hashim Thaçi. Moschopoulos ka thënë, po ashtu, se kosovarët mund të pajisen tash e tutje me viza greke në Prishtinë.

(20 shtator) Asambleja e Përgjithshme diskuton për Kosovën

Nju Jork - Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara është pajtuar që të debatojë kërkesën e Serbisë për të marrë mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë lidhur me ligjshmërinë e pavarësisë së Kosovës. Zëdhënësi i presidentit të Asamblesë së Përgjithshme, Enrique Yeves, i ka thënë Agjencisë Franceze te Lajmeve(AFP) se asambleja ka miratuar rekomandimin e komisionit të saj të përgjithshëm, që kjo çështje të vendoset në agjendën e sesionit të 63-të.



Grupi Ndërkombëtar i Krizave

(25 shtator) GNK: Tranizicioni i brishtë i Kosovës

Prishtinë - Kosova ka ndërmarrë hapin e parë në ndërtimin e shtetit, por komuniteti ndërkombëtar ka dështuar në përmbushjen e zotimeve dhe perspektiva e një ndarjeje faktike po rritet, ka vlerësuar Grupi Ndërkombëtar i Krizave. Në raportin më të ri të titulluar "Tranzicioni i brishtë i Kosovës", GNK ka thënë se komuniteti ndërkombëtar që nga 17 shkurti, nuk ka vendosur një bazë të qëndrueshme. "Kosova po dëshmon të jetë një test i vështirë dhe vendimtar për politikën mbrojtëse dhe të sigurisë së BE-së, por vullneti politik i parë para shkurtit, po zbehet", ka thënë Sabine Freizer, drejtoreshë e GNK-së për Evropën.



Alexander Stubb

(27 shtator) Stubb: Kosova nuk krahasohet me Abkazinë

Pragë - Ministri i jashtëm i Finlandës dhe njëherësh kryesuesi i radhës i OSBE-së, Alexander Stubb, i ka hedhur poshtë si të paqëndrueshme krahasimet mes rastit të Kosovës dhe rajoneve të Abkazisë dhe Osetisë së Jugut në Gjeorgji. "Kosova ka qenë një rast veçantë. Atje kemi pasur një proces gati tetë vjeçar të drejtuar nga Kombet e Bashkuara. Në Kosovë kemi pasur një përpjekje të përgjithshme ndërkombëtare. Po kështu po të shohim dhe vendet që i kanë njohur. Në rastin e Abkazisë dhe Osetisë së Jugut njohja është shumë e limituar, vetëm dy vende i kanë njohur", - ka thënë Stubb në një intervistë për Radion Evropa e Lirë.

(30 shtator) Tadiq: Nuk përjashtohet ndarja e Kosovës

Beograd - Kryetari i Serbisë, Boris Tadiq, ka vlerësuar se ekziston mundësia e ndarjes së Kosovës, por vetëm nëse janë shqyrtuar të gjitha opsionet lidhur me statusin e Kosovës. "Jam i gatshëm të mendoj edhe për këtë opsion, nëse i kemi shqyrtuar të gjitha opsionet, që janë shumë", i ka deklaruar Tadiq, Radio Televizionit të Serbisë. ■

Histori Islame (23)

Personalitetet më t para dhe pas vdekjes s

Nëse do të kishim filluar të numëronim lozën nga Keabi, i cili radhitet në brezin e nëntë deri tek Muhammedi s.a.v.s., do të thoshim se të gjitha figurat më eminente të Islamit i gjejmë nga ky njeri...



Muhamed JUSUFI -KAJOLLI

Arabët nuk kanë arritur ta regjistrojnë lozën familjare që nga Ismaili a.s., birit të Ibrahimit a.s. Themi prej Ismailit a.s. sepse ky njeri ishte braktisur me të ëmën e vet (Haxheren) nga babai tij,, dhe këta arrijnë të mbijetojnë në një luginë të rrethuar prej shkëmbinjve të pjekur dhe përcëllues. Kur ky qe rritur, ishte martuar me një femër të fisit arab. Loza familjare e paraqitur, ka një ndërprerje midis tij dhe të parit të fisit Kurejsh-Adnanit, emra të regjistruar në këtë familje të arabizuar.

Nëse Muhammedi s.a.v.s. numërohet të jetë brezi i 32-të, nga njeriu i parë i regjistruar në këtë fis me emrin Adnan të kësaj familje, mund të themi se kemi të bëjmë me një periudhë prej tetë deri në nëntë shekujsh, ndërsa Ismaili a.s. mendohet të ketë jetuar para ardhjes së Muhammedit s.a.v.s. tetëmbëdhjetë shekuj më parë. Emrat që mungojnë nga loza e këtij pejgamberi, janë rreth një milenium. Sidoqoftë, gojëdhënat thonë se fisi kurejsh e ka prejardhjen nga Ismaili a.s. Se këto gojëdhëna janë të sakta, dhe se janë shumë të besueshme flet objekti i kultit (Qabeja) i ngritur nga ky djalosh (Ismaili a.s.) me babain e tij, Ibrahimin a.s. Ky objekt, që kur kishte filluar të ngrihej, ishte dedikuar për faltore dhe ishte bërë vend pelegrinësh i Gadishullit Arabik. Gojëdhënat e tilla janë të qëndrueshme, për të mos thënë se këtë origjinë na e vërteton edhe vetë pejgamberi s.a.v.s., tek i cili muslimanët nuk kanë kurrfarë dyshimi.

Për të mos radhitur të gjithë të emrat që rrjedhin nga Adnani në këtë temë, i këshilloj lexuesit e interesuar që të shikojnë më gjerësisht Atllasin Historik të Islamit të dr. Husejn Muenis-it. Ndërsa ne do të mjaftoheshim me lozën e disa personaliteteve si: Ebu Bekri, Omeri, dhe familja emevite, sepse me këto dhe disa personalitete të tjera do të kemi punë në vazhdim. Këtë lozë e sjellim për ta bërë me dije se fisi kurejsh rrjedh prej një barku; prej tyre, dikush është më afër e dikush më larg me Muhammedin s.a.v.s.

Nëse do të kishim filluar të numëronim lozën nga Keabi, i cili radhitet në brezin e nëntë deri tek Muhammedi s.a.v.s., do të thoshim se të gjitha figurat më eminente të Islamit i gjejmë nga ky njeri. Keabi ishte babai i Murretu-t, ky i Kilab-it, ky i Kusej-it, ky i Abdul Menaf-it, ky i Hashim-it, ky i Abdul Mutalib-it, ky i Abdullah-it, ky i Muhammedit s.a.v.s.

Për të kuptuar më qartë këtë ndarje do të mundohem të paraqes figurativisht këtë lozë, si më poshtë:

Nr	Keabi i biri Luejjit							
1.	Mure	-	-	-	-	-	-	**Adij**
2.	Kilab	-	-	-	-	-	**Tejjim**	-
3.	Kusej	-	-	-	-		-	-
4.	Abdul Menaf	-	-	-	-	-	-	-
5.	**Hashim**		**Abdushems**				-	-
6.	**Abdul Mutalib**		**Umejje el Ekber**				Ebu Bekr Sidik	Omer bin Hatab
7.	Abdullah	Ebu Talib	As	Ebu As	Sufjan	Harb	-	-
8.	Muhammed s.a.v.s	Ali	Amër	Afan	Tulejk	Ebu Sufjan	-	-
9.		Hasan -Husejn		Osman	Sead ebi Vekas	Muavije	-	-

Me siguri që lozën e emevitëve ose të Umejadëve do ta paraqesim më gjerësisht në numrat vijues për shkak se kjo familje ka pasur më shumë kalifë se ata të Abdul Mutalibit. Kalifët nga loza e këtij të fundit përfundon me Hasanin, djalin e Aliu r.a., ndërsa në familjen e Umejjes fillon nga Muavije, birit të Ebu Sufjanit, emra që radhiten në numrin nëntë të kësaj tabloje.

Përshkrim i shkurtër historik i dy vëllezërve Hashim dhe Abdushems

Abdul Menafi ishte babai i Hashimit dhe Abdushemsit. Hashimi ndër arabët e Hixhazit (Arabia e mesme dhe veriore) njihet si figura më kryesore brenda kurejshëve, i cili kishte filluar lidhjet tregtare midis arabëve dhe bizantinëve.

Më herët, këto lidhje kishin qenë të shkëputura për shkak të influencës së jemenasve në Hixhaz. Ashtu siç kemi theksuar më herët, Hixhazi herë binte politikisht nën influencën perse me anë të mbretërisë jemenase në jug të Gadishullit, e herë në atë bizantine përmes mbretërisë së gasasitëve në veri të këtij Gadishulli.

Pra, në vitin 510, kur vdes Hashimi gjyshi i Muhammedit s.a.v.s., marrëdhëniet ekonomike dhe politike të hixhazasve ishin shumë të qëndrueshme me bizantinët. Për të vazhduar marrëdhëniet e mira midis perandorisë bizantine dhe tokave të "lira" të Hixhazit, përfaqësuesit e kësaj perandorie kishin kërkuar nga kjo familje të dinin se kush do ta pasonte Hashimin. Si duket, prej personave më të aftë për të vazhduar marrëdhënie të mira ekonomike dhe politike me bizantinët ishte djali i vëllait të Hashimit, Ummeje el Ekber-i, i biri i Abdushembit.

Kjo kërkesë kishte bërë që familja të bënte një ndarje interesash midis tyre.

Djemtë e Abdushemsit, tani e tutje,

ë njohura të Mekës, ë Muhammedit s.a.v.s.

do të merreshin me politikën e jashtme të qytetit-Mekës, ndërsa djemtë e Hashimit do të merreshin me ruajtjen e rendit të brendshëm, gjegjësisht me organizimin e haxhit (pelegrinëve), me pusin e Zemzemit, e kështu me radhë me organizimet e brendshme.

Kësaj familje ju shtua reputacioni edhe më shumë tek perandoria bizantine kur jemenasit me në krye Ebrehenë u orvatën ta rrënojnë Qabenë në vitin 570, në vitin e lindjes së Muhammedit s.a.v.s.

Për ta kuptuar më mirë se kush ishin djemtë e Umejjes do të kujtojmë edhe tri ngjarje të tjera:

1. Osmani konsull

Osmani na kujton marrëdhëniet politike midis perandorisë bizantine, gjegjësisht atë të mbretërisë së arabëve të veriut dhe mekasve. Ebu Sufjani, prijësi politik i mekasve, kishte ngarkuar Osmanin të mbante lidhjet me të krishterët e veriut që përfaqësoheshin nga Abul Emir el Eshab-i. Këtu kujtojmë se në këtë kohë Osmani kishte deklaruar Islamin, por si në çdo vend, lidhja e gjakut kishte bërë të veten. Meqenëse Osmani i përkiste trungut familjar të Umejjes dhe ishte djali i vëllait të Ebu Sufjanit, ky i fundit në fillim nuk kishte marrë masa kundër tij.

Takimet e shpeshta të Osmanit me të krishterët kishin ndikuar që Osmani të kishte një gjendje shumë të mirë materiale. Ai ishte pasaniku më i madh ndër të gjithë muslimanët dhe një prej donatorëve më kryesorë të muslimanëve.

Të krishterët Osmanin e quanin *Filarikh* për shkak të edukatës dhe sjelljeve të tij të mira. Për një kohë të shkurtër Osmani vendosi konsullatën e parë në Krahinën *"Thugur el Mukimin"* e kjo ia shtoi të hyrat edhe më shumë.

Në periudhën medinase, kur muslimanët po përparonin çdo ditë e më shumë, si duket kjo lidhje e hershme e umejjitëve u caktua nga Muhammedi s.a.v.s. që të vazhdonin propagandën e tyre në veri të Gadishullit. Muhammedi s.a.v.s. kishte caktuar si të dërguar të muslimanëve në zonat veriore të Gadishullit, Amër bin Sejjid bin As bin Umejjen, e më vonë Amër bin Asin, njeriun që njihet në histori si dora e djathtë e Muaviut. Kjo familje kishte shtrirje të gjerë tregtare dhe influencë politike në këtë rajon.

2. Fillimi i betejës së Bedrit.

Ebu Sufjani, djali i Harbit, axha i Osmanit ishte bërë tregtari më i madh i të gjithë arabëve të Hixhazit. Historianët kanë shënuar sasinë e mallrave të tij në vitin e dytë të hixhretit, kur Muhammedi s.a.v.s. ia bllokoi rrugën këtij tregtari të madh, vendim ky që shkaktoi fillimin e Betejës së Bedrit. Ebu Sufjani atë vit kishte arritur të sillte nga Kudsi-Jerusalemi në Mekë 2500 deve të ngarkuara me mall. Për sigurimin e këtij malli, kishte me vete treqind e sa njerëz. Gjithashtu, historianët na tregojnë se malli nuk ishte i gjithi i tij, por në këtë mall kishin pjesë edhe disa tregtarë bizantinë. Kjo tregon se Ebu Sufjani ishte njeri me influencë të madhe në mbretërinë arabe, nën kufijtë e perandorisë bizantine. Gjithashtu, mësojmë se në këtë kohë Ebu Sufjani kishte blerë patundshmëri në krahinën Bilkae të kësaj perandorie, të njohur me emrin Bekbesh.

3. Përgjigja e Amër bin Asit

Pas këtij përshkrimi të shkurtër, themi se familjet që kishin influencë historike ndër kurejshët ishin familja e Hashimit dhe Abdushemsit, gjegjësisht atij të Muhammedit s.a.v.s. dhe të Ebu Sufjanit. Ndërsa familja e Ebu Bekrit dhe Omerit nuk kishin kurrfarë influence gjenealogjike. Ardhja e Ebu Bekrit dhe pastaj e Omerit në krye të shtetit të ri të muslimanëve si Kalif (zëvendësues i Muhammedit s.a.v.s.) ishte rezultat i kontributit personal të tyre të pakontestueshëm.

Se sa kishte ndikim Ebu Bekri, Kalifi i Parë i muslimanëve tek familja e Umejjitëve flet përgjigja e Amër bin Asit, djali të axhës së Ebu Sufjanit. Ebu Bekri për të vazhduar politikën e Pejgamberit s.a.v.s. kishte kërkuar prej kësaj familje që të vazhdonte të njëjtën politikë, ndërsa një prej djemve të tyre kishte kërkuar të përfaqësohej në qeverinë e tij, duke iu ofruar post ministror. Amri ibn As, i ishte përgjigjur: *"Ne jemi bijtë Ebi Ehajhas* (ofiq i familjes së Sead bin Asit) *dhe pas vdekjes së të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s., ne nuk do t'i shërbejmë askujt asnjëherë."* Kjo familje kishte vazhduar përhapjen e Islamit në viset veriore të Gadishullit dhe kishte hyrë thellë në tokat e Bizantit, në kohën qw ishin kalifë Ebu Bekri dhe Omeri r.a.

Mendoj se edhe këta shembuj do të jenë të mjaftueshëm për analizat tona të mëtutjeshme. Këta shembuj tregojnë se pasardhësit e Abdushemsit, prijësit politik të mekasve, pas hyrjes së tyre në Islam pretendonin postet udhëheqëse. Për një kohë shumë të shkurtër, këta pasardhës do t'ia arrinin qëllimit. ■



Portret i hafëzit më të ri të Republikës së Kosovës

Djaloshi që premton shumë

Ëndrrën e tij dhe të familjes për të qenë një nga hafëzët e Kur'anit të Shenjtë, Jasiri arriti ta realizojë në moshën 11 vjeçare. Ai ndihet shumë i lumtur dhe krenar, dhe s'mund ta përshkruajë ndjenjën e të qenit hafëz.

B. SEJDIU

Lajmi për djaloshin 11 vjeçar, Jasir Krasniqi, i cili qe bërë hafëzi më i ri i Kosovës, i publikuar në numrin e kaluar të revistës "Paqja", ka shtuar kërshërinë e lexuesve të cilët dëshirojnë të mësojnë më tepër për këtë djalosh që në moshë kaq të re arriti ta mësojë përmendsh Kur'anin...

Jasiri është i lindur me 20 tetor të vitit 1996, në qytetin e bekuar të Medinës në Arabinë Saudite, gjatë kohës kur i ati i tij, prof.dr. Shefqet Krasniqi ishte me studime në këtë vend.

Mësimet i filloi në moshën pesë vjeçare në shkollën fillore "Meto Bajraktari" në Prishtinë. Krahas gjuhës shqipe, Jasiri mësoi të lexonte edhe në gjuhën arabe. Që në moshën 6 vjeçare, ai e kishte mësuar leximin e Kur'anit në gjuhën arabe.

Nxënës i Mulla Mahmut Asllanit në Tetovë

Në moshën 8 vjeçare, kur ishte në klasën e IV-të, i nxitur nga babai i tij, Jasiri vendos që të marrë përsipër një punë shumë të çmueshme dhe të rëndësishme, një mision të shenjtë dhe shumë të vështirë, nxënien përmendsh të Kur'anit të Shenjtë. Për ta përmbushur me sukses detyrën që kishe marrë përsipër, prindërit e dërgojnë në Tetovë.

Larg nga shtëpia, por i përkrahur në mënyrë të pakufishme nga familja, Jasiri, në Xhaminë e Larme në Tetovë, për dy vite e gjysmë do të merrte mësime nga hafëzi Mulla Mahmut Asllani, një mësues shumë i dashur dhe i respektuar, jo vetëm për të, por për të gjithë, e sidomos për mbi 150 hafëzë që ishin nxënës të tij e që kishin arritur ta mësojnë Kur'anin përmendsh në mënyrë të suksesshme.

Ndonëse në moshë shumë të re, Jasiri ambientohet shpejt në qytetin e Tetovës ku krahas mësimit të Kur'anit, vazhdon shkollimin në njërën nga shkollat fillore të këtij qyteti. Edhe pse i angazhuar kryesisht në mësimin e Kur'anit, ai nuk ngeci në mësimet e shkollës, pasi që i ndihmoi shumë përkrahja dhe mirëkuptimi i mësuesve.

Çdo ditë, pas përfundimit të orarit të shkollës, Jasiri i vendosur që ta përfundojë sa më mirë dhe sa më shpejt misionin për të cilin kishte shkuar, ia kushtonte pothuajse të tërë pjesën tjetër të ditës nxënies përmendësh, për ta mësuar dhe përsëritur mesatarisht një faqe në ditë nga Kur'ani i Shenjtë.

Ëndrrën e tij dhe të familjes për të qenë një nga hafëzët e Kur'anit të Shenjtë, Jasiri arriti ta realizojë në moshën 11 vjeçare. Ai ndihet shumë i lumtur dhe krenar, dhe s'mund ta përshkruajë ndjenjën e të qenit hafëz.

Rikthimi në Prishtinë...

Tani hafëzi më i ri i Kosovës jeton përsëri në mesin familjar në shtëpinë e tij në Prishtinë, me dy prindërit, dy vëllezër, dhe një motër. Ai vazhdon të vijojë mësimin në klasën e VII-të, të shkollës fillore "Meto Bajraktari" në Prishtinë. Tanimë shumica e shokëve dhe mësuesve të tij e dinë që ai është hafëz i Kur'anit të Shenjtë dhe të gjithë e kanë mirëpritur kthimin e tij në shkollë. Shpesh, ai detyrohet nga shokët apo mësuesit që të shkëpusë ndonjë pjesë nga ajo që ka zënë përmendësh, për ta kënduar në praninë e tyre.

Edhe pse në moshë shumë të re kishte mësuar leximin e Kur'anit në gjuhën arabe, ashtu si pjesa tjetër e familjes, tani ai ndihet shumë më mirë gjatë leximit të Kur'anit. Por angazhimi dhe puna për nxënie përmendësh nuk përfundon kurrë. Ai çdo ditë ia kushton një kohë të veçantë përsëritjes së Kur'anit në mënyrë që ta ruajë atë që e ka mësuar.

Përkundër angazhimit në mësimet e shkollës dhe përsëritjes së Kur'anit, Jasiri gjen kohë të lirë për t'u argëtuar me moshatarët e vet në lojëra kompjuterike apo të tjera. I pëlqen sporti, e në veçanti futbolli. Ende nuk është i përcaktuar se çfarë drejtimi do të marrë në të ardhmen, por ka dëshirë ta mësojë kuptimin e asaj që e ka mësuar përmendësh dhe iu bën thirrje shokëve dhe shoqeve të tij që edhe nëse nuk mund ta mësojnë përmendësh, atëherë të paktën ta mësojnë leximin e Kur'anit të Shenjtë në gjuhën origjinale.

Babai Shefqeti optimist për të ardhmen e Jasirit

Si një 11 vjeçar është normale që Jasiri nuk ka vendosur se çfarë drejtimi do të marrë në të ardhmen. Por, babai i tij, prof.dr. Shefqet Krasniqi, mendon që Jasiri duhet ta përforcojë atë që ka mësuar, pastaj të paraqitet para dijetarëve dhe hafëzëve në botën arabe, në mënyrë që të marrë "ixhazet" (një lloj diplome) që nuk është shumë i rëndësishëm si dokument, por hap rrugë që të bëhet pjesë e zinxhirit të mësimit të Kur'anit duke filluar nga hafëzi ku Jasiri e ka nxënë përmendësh, dhe duke vazhduar deri te Pejgamberi a.s., deri te Xhibrili a.s., dhe deri te Allahu i Madhëruar. Ai mendon që Jasiri të fillojë nxënien përmendësh të disa librave të hadítheve, si dhe disa pjesëve nga fikh-u, dhe deri në përfundim të shkollës së mesme të ketë mundësi t'i kuptojë, ashtu që në të ardhmen të përgatitet si një hoxhë i madh për t'ia përcjellë atë dije popullit të tij. ■



Fituesit e çmimit Nobel për 2008-tën


Herald zur Hausen


Françoise Barré-Sinoussi


Luc Montagnier


Yoichiro Nambu


Makoto Kobayashi

Nga data 6 deri më 13 tetor, në Oslo të Norvegjisë, u bë ndarja e çmimit Nobel, i cili jepet për të arriturat në fushat e Mjekësisë, Fizikës, Kimisë, Letërsisë, Paqes dhe Ekonomisë. Laureat të këtij çmimi për këtë vit janë gjithsej 12 individë. Tre çmime (për Mjekësi, Fizikë dhe Kimi) janë ndarë në tri pjesë, çmimet e tjera janë (në fushat Letërsi, Paqe dhe Ekonomi) të plota.

Më poshtë po i paraqesim fituesit e çmimeve në mënyrë kronologjike sipas datës së ndarjes:

MJEKËSI

6 TETOR 2008

Çmimi Nobel në Fiziologji ose Mjekësi për 2008-tën i është ndarë tre shkencëtarëve: Herald zur Hausen, Françoise Barré-Sinoussi dhe Luc Montagnier për zbulimet e tyre. "Zbulimi i virusit human papilloma që shkakton kancerin cervikal" e merr gjysmën e çmimit të Nobelit Herald zur Hausen kurse gjysma tjetër u ka takuar dy shkencëtarëve tjerë për "zbulimin e tyre të virusit Human Immunuodeficiency Virus (HIV)".

FIZIKË

7 TETOR 2008

Çmimi Nobel në Fizikë këtë vit i është ndarë tre fizikanëve: Yoichiro Nambu, Makoto Kobayashi dhe Toshihide Maskawa. Yoichiro Nambu ka fituar gjysmën e çmimit për "zbulimin e tij të mekanizmit të simetrisë së thyer spontanisht në fizikën subatomike", kurse dy fizikanët japonezë kanë fituar gjysmën tjetër të çmimit për "zbulimin e tyre të origjinës së simetrisë së thyer e cila parashikon ekzistencën e më së paku tri familjeve të kuarkeve në natyrë".

KIMI

8 TETOR 2008

Në fushën e kimisë çmimin e Nobelit për këtë vit e fituan tre kimistë amerikanë, Osamu Shimomura, Martin Chalfie dhe Roger Y. Tsien, për "zbulimin dhe zhvillimin e tyre të proteinës së gjelbër flouroshente GFP".

LETËRSI

9 TETOR 2008

Shkrimtari francez, Jean-Marie Gustave Le Clézio, ka fituar çmimin e sivjetshëm Nobel për letërsinë. Akademia mbretërore në Stokholm bëri të ditur se këtë çmim e ndan për autorin francez për kontributin e tij në "depërtime të reja, aventurën poetike dhe ekstazën sensuale, studiues i humanitetit përtej dhe poshtë civilizimit sundues".

PAQE

10 TETOR 2008

Këtë vit çmimin prestigjioz për Paqe e ka fituar kryenegociatori për statusin e Kosovës, ish-presidenti finlandez Martti Ahtisaari "për përpjekjet e tij, në kontinente të ndryshme dhe për më tepër se tri dekada, për të zgjidhur konfliktet ndërkombëtare".


EKONOMI


13 TETOR 2008


Çmimi Nobel për shkencat ekonomike këtë vit iu nda ekonomistit amerikan Paul Krugman "për analizat e tij në modelet e tregjeve dhe vendeve në aktivitetin ekonomik". ■


Përgatiti: Osman D. GASHI


Paul Krugman


Martti Ahtisaari


Jean-Marie Gustave


Osamu Shimomura


Martin Chalfie


Toshihide Maskawa


Roger Y. Tsien

Pasqyrë e shkurtër mbi organizimin e shqiptarëve në Turqi

Shumë shoq

Sot në Turqi ka shumë shoqata kulturore e humanitare të formuara nga vetë shqiptarët që jetojnë atje, por mund të thuhet që aktivitet e tyre janë pothuajse të vdekura fare. I vetmi "aktivitet" është tubimi i shqiptarëve të lagjes për të pirë ndonjë gotë çaj!

Agron ISLAMI

Gjatë tërë historisë së popullit shqiptar janë regjistruar shpërngulje të ndryshme, si pasojë e regjimeve të ndryshme nëpër kohë. Si rezultat i këtyre shpërnguljeve nga atdheu mëmë, sot shqiptarët janë të ndarë nëpër pjesë të ndryshme, kush në tokën e etërve të tyre, por që konsiderohet pakicë (minoritet) si në Preshevë, Medvegjë , Bujanovc, Shkup e Çamëri, e kush në vendet mike Turqi, Amerikë...

Sot është e pamundur që të dihet numri i përgjithshëm i shqiptarëve që jetojnë nëpër vende të ndryshme. Sipas të dhënave, mbrohet ideja se numri i përgjithshëm i shqiptarëve në botë është afër 25 milionë, ndërsa vetëm në Turqi, mendohet se jetojnë më shumë se 4 milionë shqiptarë, shumica e të cilëve e kanë kultivuar dhe ruajtur kulturën dhe traditën shqiptare deri në ditët e sotme.


45 kryeministra shqiptarë!

Shqiptarët në terminologjinë turke njihen me emrin arnavut, ndërsa në historinë e Turqisë njihen si një popull fisnik e i besueshëm që i dha perandorisë turke mbi 45 kryeministra. Në veçanti, sanxhaku i Kosovës dha shumë njerëz të dijes, me në krye Sami Frashërin (Shemsettin Sami) e Mehmet Akif Ersoyin dhe shumë dëshmorë në luftën e Çanakkales.

Historia na mëson se perandoria osmane ishte një fuqi që, për 500 vite, sundoi një pjesë të mirë të botës. Ajo ishte një superfuqi e kohës që për model administrimi kishte legjislacionin islam (sheriatin). Sipas këtij legjislacion-administrimi, dallimet mes popujve ishin musliman dhe jomusliman. Pasi që perandoria që administronte këto vende ishte muslimane, të gjithë ata që e pranonin fenë islame ishin pjesë e perandorisë, ashtu siç ishin edhe jomuslimanët, por këta për dallim nga muslimanët paguanin xhizjen, që ishte tatim ndaj shtetit për t'iu siguruar pasurinë dhe jetët e tyre nën flamurin e perandorisë. Duhet theksuar se muslimanët kishin shumë detyrime ndaj perandorisë, ngase veç ishin pjesë e saj, siç ishte ushtria e të ngjashme, ndërsa jomuslimanët nuk ishin të ngarkuar me angazhime të tilla.

Sistemi i administrimit të popujve që hynin nën sundimin osman ishte shumë identik me sistemin e tanishëm të forcave ndërkombëtare, si ndarja e administrimit në zona që në terminologji njihet me emrin 'sanxhak', kryetari i zonës ishte nga popullata vendore që ishte i lidhur direkt me padishahun. Të gjithë banorët e popujve që administroheshin nga perandoria osmane kishin të drejtën të lëviznin nga një vend në një tjetër vend dhe, si rezultat i këtij sistemi, Turqia ishte vendi i shumë popujve me prejardhje të ndryshme, që jetojnë edhe tani në Turqi: shqiptarët, boshnjakët, grekët, gjeorgjianët, çerkezët, romanët, arabët..., dhe që të gjithë janë të barabartë para ligjit shtetëror.

Të gjithë këta popuj, që sot jetojnë në Turqi, nëse ju drejtohesh me pyetjen: 'çfarë je?', do të përgjigjet se është turk e më pas do ta cekë pre-



Pamja nga Arnavutkoy (Fshati, vendi i shqiptarëve), vend afër Stambollit, Turqi

ata, pak aktivitet!

jardhjen e tij qoftë arnaut, boshnjak etj. Përkundër kësaj, ata në njëfarë mënyre mundohen ta ruajnë identitetin e tyre dhe ajo bëhet vetëm përmes gjuhës, gjë që deri në ditët e sotme mund të thuhet se ia kanë arritur me sukses.

Gjeneratat e vjetra të shqiptarëve në Turqi e kanë ruajtur gjuhën shqipe por, fatkeqësisht, dita ditës po shuhen familjet shqiptare në Turqi për shkak se gjeneratat e reja nuk e kanë një mundësi te tillë. Si pasojë e dinamikës së jetës që ka marrë një karakter tjetër zhvillimi, të rinjtë shqiptaro-turk po e humbasin traditën shqiptare dhe me këtë po e humbin edhe identitetin e tyre.





Aktivitete të zbehura të shoqatave shqiptare

Sot në Turqi ka shumë shoqata kulturore e humanitare të formuara nga vetë shqiptarët që jetojnë atje, por mund të thuhet që aktivitet e tyre janë pothuajse të vdekura fare. I vetmi "aktivitet" është tubimi i shqiptarëve të lagjes për të pirë ndonjë gotë çaj!

Nga stacioni i autobusëve në Stamboll e deri në qendër të Stambollit të zë syri tabela shoqatash shqiptare të shumta si: "Kosovalilar dernegi" "Prizrenliler dernegi", "Kosova Gilanlilar dernegi", "Kumanovalılar kültür dernegi", etj. Në programet e këtyre shoqatave parashihet edhe ndihma për studentët shqiptarë që studiojnë në Turqi, ndihma për Kosovën, organizimi i manifestimeve kulturore shqiptare në festat e veçanta shqiptare, në mënyrë që ta ngjallin jetën dhe frymën e traditës dhe kulturës shqiptare në lokalitetin ku gjenden dhe t'i ofrojnë sadopak gjeneratës së re turko-shqiptare atmosferën shqipe. Mirëpo, për fat të keq, shumica e tyre nuk e realizojnë programin as përafërsisht. Sa për ilustrim, po përmend faktin se studentët shqiptarë që studiojnë në Turqi ndihmohen shumë më tepër nga shoqata të ndryshme kulturore e bamirëse turke si "Deniz Fener", "Tika", "Istanbull", etj., se sa nga ato shqiptare.

Se sa i madh është numri i shoqatave shqiptare në Turqi, kam pasur rastin ta shoh edhe ditën kur u organizua festimi i ditës së pavarësisë së Kosovës, në komunën Eyup nga ana e komunarëve, me pjesëmarrjen e qeveritarëve nga parlamenti i Turqisë dhe Kosovës. Salla ku festohej ishte mbushur në të katër anët me reklamat dhe logot e shoqatave shqiptare që veprojnë në Turqi, por, për fat të keq, aktivitetet e tyre nuk vërehen fare, apo janë aq të kufizuara sa s'hetohen...

Pavarësisht nga niveli i organizmit të shqiptarëve në Turqi, konsiderojmë se për fatin e një komuniteti jo të vogël (4 milionësh), siç janë shqiptarët në Turqi, qeveritë shqiptare (Kosovë e Shqipëri) duhet të japin kontributin e tyre që të mos shkohet deri te asimilimi i këtyre bashkatdhetarëve tanë. Kjo mund të bëhet fare lehtë nëpërmjet marrëveshjeve të ndërsjella me shtetin mik të Turqisë. Një hap shumë i qëlluar dhe i rëndësishëm në këtë drejtim është që të kërkohet nga qeveria turke hapja e katedrave për studimin e gjuhës shqipe, ashtu siç e kanë një të drejtë të tillë turqit në Kosovë dhe Shqipëri. ■

(Autori është student i shkallës së tretë në Universitetin "Sakarya" në Turqi)

Bumerang

(Vijon nga numri i kaluar)

Mimioza SINANI

Edlira nuk kishte njohuri të thella për fenë islame, por zemra e saj e pastër dhe e çiltër e kuptonte se shoqes së saj të mirë e të dëlirë po i bëhej një padrejtësi e madhe. E gjithë ajo tymnajë, pas së cilës përcëllonte zjarri i urrejtjes fetare, e kishte bazën te mungesa e vizionit transcendent të elitave të pashpirta, materialiste e pragmatiste që i nënshtroheshin çdo konjunkture për hir të interesave të tyre egoiste. Tek qarqet intelektuale snobiste ekzistonte një lloj paranoje dhe qasje provokuese ndaj fesë islame. Gjeneratat e intelektualëve që ishin në pushtet ishin formuar nën ombrellën ateiste. Ata ishin një lukuni hienash që ishin ende të fortë dhe persona me ndikim. Për ta vlerat fetare e morale ishin bërë 'hi e pluhur' në muzgun e kohës. Hapësira mediatike shqiptare, si një trampolinë degjeneruese, e kishte zhvlerësuar rolin e faktorit fetar, e sidomos atë islam, në përcaktimin e kahut dhe ecurisë drejt rrjedhave globale integruese. Kjo klasë mediatike, si një neobizant modern, përpiqej të futej dhe të depërtonte në dhomat, korridoret dhe aneksset e ndërgjegjes së secilit dhe ta bunkerizonte mënyrën e të menduarit, ta betononte trurin dhe ta shterpëzonte intelektin. Sipas kësaj klase mediatike, feja islame bartte despotizmin, obskurantizmin, dhunën, arkaizmin. Mediat kishin krijuar për muslimanët imazhin më të keq të mundshëm: destruktivë, terroristë, fundamentalistë.

Sipas tyre çdo modernizëm ishte 'oksidentalizëm'. Vetëm Evropa duhej të ishte personifikim i përparimit dhe pikëpamjet e saj kulturore, ideologjike, politike dhe ekonomike, pra me një fjalë filozofia e saj e jetës duhej të konsiderohej e detyrueshme për të gjithë njerëzit e planetit. Çdo gjë tjetër cilësohej anakronike, prapanike, jocivilizuese. Dhe si për paradoks, lihej në heshtje fakti se vetë modeli perëndimor, që perceptohej si modeli më joshës i shoqërisë, dyshonte pafundësisht mbi veten e tij si një model në krizë, i paaftë të luftonte kriminalitetin, drogën, prostitucionin, korrupsionin etj.

Edlira po mendonte të gjitha këto ndërkohë që kishte mbërritur te hyrja e pallatit të saj. U ngjit lart dhe hapi derën me përtim. Babai i saj ishte mjek, ndërsa nëna arkitekte. Ata ishin tepër të angazhuar me punët e tyre dhe Edlirës iu duk se shtëpinë e kishte pushtuar një heshtje vrasëse. Ajo ishte vajzë e vetme dhe jeta e saj ishte e mbushur me ditë vetmie e mërzie. Sa shumë dëshironte të kishte motra dhe vëllezër. Orenditë dhe kolltukët luksozë që mbushnin shtëpinë e saj i sillnin ftohtësi. Sa shumë do të dëshironte të bisedonte tash me prindërit e saj. Por ata ishin gjithmonë të zënë, të zënë, të zënë. Ata punonin 10-12 orë në ditë dhe e kishin mendjen gjithnjë të mbingarkuar. Puna ishte si një ritual makabër që i gllabëronte çdo mëngjes dhe i lëshonte në orët e vona të pasdites të rraskapitur e të sfilitur. Edhe kur ktheheshin në shtëpi hapnin televizorin dhe dëgjonin lajmet që ua bombardonin trurin pa pushim. Më pas hapnin kompjuterin, pa u prehur aspak nga presioni i punës. Lexonin gazeta, revista, katalogë të ndryshëm, oferta për produkte dhe shërbime, duke e pushtuar kështu tërë kohën dhe duke mos krijuar aspak ndonjë lidhje shpirtërore me Zotin. Sakrifikonin shëndetin dhe preokupoheshin për të fituar sa më shumë, duke u mbështetur vetëm mbi forcat e veta dhe duke mos kërkuar ndihmë e fuqi nga Zoti i Gjithëfuqishëm. Edlirës iu kujtuan fjalët e Teognisit: "Ata që sot kanë shumë, lakmojnë dyfishin. Pasuria kthehet tek njeriu në çmenduri." Pasuria e krijuar për të realizuar nevojat e tyre të jetës ishte kthyer në qëllim në vetvete. Ajo ishte shndërruar për ta në një nevojë të pangopshme, të paanë, që nuk fashitej kurrë. Në themel të saj qëndronte një vullnet i shtrembër, një dëshirë për të pasur me shumë se të tjerët.

Edlirës iu duk vetja si një somnambule që endej në një kaos vlerash pa pasur ndonjë orientim. Ndjeu vogëlsinë e botës së vet dhe parëndësinë e qëllimit të jetës së saj. Deri më tash e kish ushqyer kureshtjen e saj duke lexuar "letërsi të verdhë", "bulevardeske" apo "limonadë", por tani po ndiente një hapësirë boshe në shpirtin e saj. E kish kuptuar se vetëdija transcendentale për Zotin ishte një virtyt i bashkëlindur me të. Ndjenja fetare ishte më e qëndrueshmja, më e rrënjosura dhe e vetmja që mund t'i përmbushte nevojat thelbësore të saj. Iu kujtuan lisat: ata rriten e rriten, lëshojnë shtat sikur duan të arrijnë në qiell por nuk harrojnë të lëshojnë rrënjët thellë e më thellë për t'u lidhur sa më shumë me zemrën e dheut.

Edlirën po e hante vetmia. Ishte zhytur në ujërat e thella të deteve të zemrës. Mendimet filluan t'i kacavirreshin në pemën e mërzisë. Hodhi shikimin e përhumbur diku përjashta, larg katër mureve që e rrethonin. Një valë nxehtësia ia pushtoi trupin. Nuk po e zhuriste dielli që kishte lart, por zjarri që kishte përbrenda. Dielli i shpresës po mundohej të mos jepte shpirt. Rrezet e tij po përpiqeshin ta shqyenin velin e fshehtësive. Filloi të zbulojë nën nënshtresat e pavetëdijes së saj të fjetur thellësinë e shpirtit njerëzor. Ndjeu nevojën që ta ngrohte zemrën e saj me dashuri hyjnore, që ta fshinte nga mendja idenë e një bote kaotike, mizore dhe në dukje absurde. Dëshironte të gjente strehë në një univers të harmonishëm, të qartë dhe të kuptueshëm dhe të arrinte përsosmërinë me të lartë, që do t'i përmbushte kërkesat e arsyes, të ideve estetike dhe metafizike. Mjaftonte veçse pak meditim dhe ajo mund të gjente me qindra argumente për ekzistencën, forcën dhe urtësinë e të Gjithëfuqishmit nëpërmjet ligjshmërisë, precizitetit dhe harmonisë që ekzistonin në formimin e tokës, hënës, diellit, planetëve, yjeve, qiejve, në formimin e ditës, natës, erërave, shiut, maleve, lumenjve, deteve, bimëve, gjallesave dhe njerëzve, duke filluar nga atomet e deri te fenomenet më të ndërlikuara: ligjet, raportet, format, lëvizjet.

Edlira zbriti me nxitim shkallët e pallatit dhe u drej-

tua për tek shtëpia e Fatmës. Pas pak u gjend para portës së saj. E shtyu derën lehtë. Para saj shtrihej oborri i shtruar me plloça të mëdha e të pastra. Më tej ishin mbjellë plot lule dhe pemë.

Purpuri i diellit, poleni aromatik dhe petalet e luleve sikur përvijonin një konstelacion pranveror lulesh. Pemëve të kumbullave u kishte rënë një nur nusëror. Lule vjollcat, jargavanët, manjolat, karafilat dhe margaritat formonin një mozaik pistilash me kolorite të shumta. Menjëherë i doli përpara Fatma, nëna, motra dhe dy vëllezërit e saj më të vegjël, të cilët i uruan mirëseardhjen ngrohtësisht. Pak metra më tej ndodheshin edhe shtëpitë e xhaxhallarëve të Fatmës. Ajo ndjeu gëzimin e tyre të vërtetë, të sinqertë, të vetvetishëm që përhapej natyrshëm në sytë, flokët dhe lëvizjet e tyre. Zëri i fjalëve të tyre e tërhoqi me butësi në një botë të ngrohtë.

Hyri brenda. Çdo gjë ishte e pastër dhe e vendosur në vendin e vet. Në një tryezë të vogël ishte një vazo me një lule zambaku të bukur, gjethet e gjelbra të të cilit kishin hapur krahët anash tërë gëzim dhe në krye i përkundej një lule e kuqe e sapoçelur. Perdet e dhomës dhe mbulesa e tavolinës ishin të punuara me grep. Duart që i kishin punuar ato shprehnin dashurinë e dukshme të gruas që besonte te dashuria, te qielli dhe te toka, te ajri dhe uji, te dielli dhe hëna, te yjet dhe xixëllonjat, te jeta dhe vdekja. Dukej qartë se te ato duar duhej të kishte shumë dashuri. Në to ndihej ecuria e jetës, ngrohtësia njerëzore, dashuria e njeriut për njeriut, e nënës për fëmijët, e mikut për mikun.

Dy shoqet u veçuan në dhomën e Fatmës dhe filluan të bisedonin. Edlira i tregoi për ftohtësinë dhe vetminë që ndiente në shtëpinë e saj. Ndërsa Fatma i tregoi se nëna e saj ishte gjithmonë prezent në çastet kur ndahej gëzimi, hareja, pikëllimi dhe ngushëllimi, dhe në ato momente ajo luante një rol të pazëvendësueshëm. Ngrohtësia që i dhuronte nëna e saj ishte si një lumë i pashtershëm që rridhte gjithmonë dhe nuk shterej kurrë. Ajo i dukej asaj si një shpirt, si një mirësi, si dora



e Perëndisë që kishte zbritur nga qiejt në këtë botë. Fjalët që dilnin nga goja e nënës së saj i dukeshin si fjalë qiellore, fjalë jete, fjalë ëndrre.

Edlira i shfaqi dëshirën Fatmës që t'i tregonte diçka më tepër për fenë e saj. Nga fytyra e Fatmës filluan të shpërndaheshin disa rreze të ndritshme dhe depërtonjëse. Ajo filloi t'i tregonte Edlirës për dashurinë e saj të pakufishme për Krijuesin Madhështor të universit dhe për lutjet e saj të përditshme fetare:

- Namazi për mua është një lidhje e fuqishme me Zotin, është një burim i pashtershëm frymëzimi për një jetë më të lartë, më fisnike. Është një ushqim shpirtëror që më përtërit. Dëshpërimi i njeriut në këtë jetë rrjedh nga fakti se ai është një qenie e nevojave të pakufishme. Sa më tepër që i plotëson ato, aq më tepër shfaqen nevoja të tjera. Ai s'është veçse një prodhues dhe konsumues të cilin e vë në lëvizje vetëm interesi i tij vetjak. Ai synon nevoja të pafundme por mundësitë e plotësimit të tyre janë të kufizuara. Kjo bën që atë ta kaplojë mërzia. Feja islame nuk e konsideron këtë botë si luginë të ofshamave dhe psherëtimave. Ajo angazhohet për një harmonizim dhe paralelizëm mes vlerave materiale dhe shpirtërore, sepse pikërisht ekuilibri i prishur i tyre ka shkaktuar kaosin ekzistencial në civilizimin e sotëm.

Edlira e dëgjonte Fatmën me vëmendje. Fjalët e saj rrezatonin një energji që mbushnin hapësirat brenda saj. Tingëllima e zërit të saj ishte si tingëllima e një çelësi që hapte portën e shpirtit të saj. Feja islame iu shfaq me të gjithë butësinë, tolerancën dhe ngjyrimet e ngrohta që e karakterizojnë. Në besimin e Fatmës ajo nuk shihte kurrfarë paqartësie, misterioziteti apo dyshimi. Besimi i drejtë, që është shkalla më e kompletuar e dijes, i kish mundësuar asaj që të kishte një diapazon, botëkuptim dhe horizont të gjerë. Sigurisht që formimin, intuitën, inteligjencën dhe sensibilitetin e saj ajo i shihte në frytet e punës së saj, si edhe në duatë që ajo kishte bërë për to. Janë disa ndjenja të përcjella në gen, që duke rënë në truall të shëndetshëm rriten dhe lulëzojnë. Ato janë si farat e disa luleve të mrekullueshme që balta ua ka zënë frymën dhe i ka varrosur të gjalla. Ato fara lulesh janë të groposura thellë në baltë dhe presin të rimbijnë një ditë. Edlirës iu duk se gjeti një oazë që i lulëzoi ato sërish.

Njohja hyjnore e përgatiti për udhëtimin e gjatë drejt së vërtetës absolute duke e zhytur në shijen e pafundme të përjetimeve shpirtërore, ndjesive supreme dhe fërgëllimave shpirtërore.

Pas dy ditësh mësimi rifilloi sërish.

Vitin shkollor që pasoi, në bankën e dytë, në rreshtin e mesit, qëndronin dy vajza me mbulesë: Fatma dhe Edlira.

Fund 

Kritikë letrare

Struktura neutrale e

Letërsia dhe arti në përgjithësi, për Musa Ramadanin shihen se jetojnë së bashku, për njohjen e përditshmërisë, çdoherë në përmasën universale. Kjo njohje universale po vazhdon së gjurmuari, vetëm e vetëm që të gjejë pakëz jetë më ndryshe, nga ajo mëkatare-reale.




Flamur MALOKU

Leximi i poezisë së Musa Ramadanit kërkon kohën e leximit të një vetmie ekzistenciale-subjektive edhe përgjatë rileximit, për t'u shtrirë ngadalë në kohën e shkrimit, e për të hyrë në botën e fiksionit-meditimit, ku bota e fiksionit, tani në poezi bëhet trajtë dhe formë në përjetim, për të kaluar më vonë në botën e pakufishme të vetë letërsisë. Kështu, në universalen e përhershme shpirti ringjallet në poezinë e *Musa Ramadanit*, merr formë tjetër, varësisht reales. Sepse, kërkohet një jetë, përtej kornizave individuale të kësaj bote pa mëkate. E përtejshmja tani në botën e letrave shtrihet-kërkohet, sepse vetë shpirti do të jetojë në hapësirën e përgjithshme. Të jetosh në kohën reale dhe të kërkosh hapësirën e pakufishme të të jetuarit, nënkupton të mos vdesësh kurrë në botën e shkrimit-letërsisë. Prandaj, poezia e Musa Ramadanit në diskursin e saj, do të shprehë autentiken e përhershme në hapësirë, që koha dhe hapësira thyhen në diskursin e përgjithshëm-universal, shkohet madje kah gjetja e të përgjithshmes, për të ardhur kah vetja. Andaj, teksti poetik, *"MËKATET E E(HA)VËS"* i Musa Ramadanit, do të identifikohet si gjetje për veten e për vetveten në shkrimin e letërsisë. Kërkimi i vetvetes si njohje bëhet për një pamje jetësore edhe për tjetrin, para së gjithash dhe për një shpjegim të mëkateve njerëzore, të cilat do të artikulohen në shkrimin-letërsinë. Për vënien në pah të mëkateve njerëzore, si gabime shpirtërore-trupore, bëhet shkrimi fiksional, duke u bërë dëshmi, për vetë jetën e përditshme, për t'u kryqëzuar dhe identifikuar fiksioni më jetën. Për Musa Ramadanin, letërsia dhe arti në përgjithësi, shihen se jetojnë së bashku, për një njohje të përditshmërisë, çdoherë në përmasën universale. Kjo njohje universale po vazhdon së gjurmuari, vetëm e vetëm që të gjejë pakëz jetë më ndryshe, nga ajo mëkatare-reale. Poezia e Musa Ramadanit bëhet shënjuese e kësaj të përhershmeje, në frymëzimin e vazhdueshëm, për të gjetur në vazhdën e hapësirës jetëshkrimin dhe identifikimin personal, duke flakëruar vazhdimisht mëkatet e reales ekzistenciale, ku pesha e meditimit dhe luajtja me figura në kohë dhe hapësirë, do të bëhet bartëse e një sistemi të mundshëm ideor, për të thurur ngadalë në poezi, e për të mos ikur asnjëherë nga diskursi i përjetimit-shkrimit. Kjo në fiksionin e shkrimit shtresohet në formën më të mundshme ekzistenciale. Kështu, sistemi diskursiv i poezive të Musa Ramadanit, mbetet i kushtëzuar në kohën e përjetimit, i lidhur më botën e shkrimit-reales, duke dalë i shtresuar si një figurë, që teksti thellohet, pasurohet në interpretim, përherë në kuptimin poetik, për t'u shënjuar edhe në poezinë vizuale. Rrjedhat e mendimit, sa vinë e bëhen më të kapshme, mbi problemet e shumta, të cilat kërkojnë lexuesin e shënjueshëm përgjatë zhvillimit të mendimit.

Distinksioni në rrafshin e tekstit

Distinksioni në rrafshin e tekstit e të shumësisë, shtron riinterpretime, për të zbuluar në botën e shkrimit problemet, qofshin ato autoreferenciale, apo referenciale. E përditshmja bëhet referenciale, por me dhembje personale, që shpesh vihet në figurën e tensionuar, ky tensionim



...e tekstit

skicohet, atëherë kur përpara është mëkati i bërë nga njeriu, andaj pason dhembja nga subjekti, që manifestohet nëpërmjet dëshmisë dhe mendimit. Në mënyrën e veçantë të kësaj dëshmie, gjuha poetike merr përmasa në logjikën e saj, ku lexuesi sfidohet në figurën dhe në sistemin e mendimit. Mënyra e konceptimit të gjakimit shpirtëror e trupor, forcon idenë e autentikes së përhershmen në kuptimësinë e realizimit e të botëkuptimit të shprehur në tekstit; *Ngricë. Në zemër/ Acar. Brenda trupit/Cegmë. Rreth shpirtit.* Vargjet shënjojnë subjektin e mërzitur në kohë, të cilat tani bëhen pasqyrë e botës së brendshme. Shpirti, trupi, zemra janë ligështuar në kohën e mërzisë, e për të tejkaluar këtë mërzi subjekti kërkon thyerjen e kohës dhe të hapësirës, nga vetmia si dhembje karshi reales së tanishme. Kështu, në tërësinë perceptuese-konceptuale, kuptimi i poezisë bëhet i prekshëm në emocionalitet, edhe atëherë kur diskursi shkrimor kalon duke u shënjuar në vizualitetin e përjetimit e të pikturimit. Poezia vizuale realizohet me kohën, për t'u bërë kuptimësi e simbol, që më vonë në rrafshin e përgjithshëm të diskursit, përgjatë pikturimit do të determinohet e plotësohet, dhe bëhet pjesë e rëndësishme, nga ku subjekti thur tërësinë e formës dhe të kategorisë tekstuale, siç janë poezitë vizuale; "Heshturimë e humbje", "Mitike e mistike". Transformimet shpirtërore në kohë, shfaqen vazhdimisht në sistemin e ideve e të figurave poetike nga metafora, metonimia, alegoria, simboli e ironia.

Identitet shqiptar– fortësi / lashtësi

Kështu, idetë tekstuale të poezive të M. Ramadanit, në vijën e konstituimit prekin botën e ndjeshme, botë në të cilin subjekti gjakohet e vdesë pak nga pak nga dashuria, dhembja, që ka përgjatë artikulimit. Duhet mos harruar se poezitë e Musa Ramadanit janë shkruar në një kohë të vështirë. Për të vërtetuar këtë autori shënon edhe të dhëna në fund të tekstit. Përshtypja e kohës, në të cilën subjekti ndrydhet nga dhembja, vihet në komunikim me subjektin karshi objektit. Kështu, kategorizimi i kohës në vepër ndihmon ta shohim dhembjen më përafërt, edhe atëherë kur ligjërimi identifikohet më kodin nacional, ku identiteti kombëtar do të manifestohet në mënyra të ndryshme si, fortësi, lashtësi, dashuri, identifikimi i plotë karshi tjetrit (të huajt). Identiteti kombëtar në shenjen personale mbrohet deri në fund të jetës, për të zënë vend të posaçëm në pjesën dërmuese të tekstit, kjo për subjektin është sublime. Jeta, do të mbetet e pakuptimtë, nëse nuk ruhet identiteti dhe nëse nuk vdesësh për të, andaj kërkohet një vëmendje më e madhe ndaj tij. Autori është përherë është kategorik kundër çdo largimi nga identiteti kombëtar, edhe atëherë kur është në pyetje dhuna nga tjetri, e cila do të skicohet në poezinë *"(S) pastrimi etnik i shqiptarëve"*, apo në poezinë *"Vrapuesi i Epirit dhe Vrapuesja e Prizrenit"*. Kështu, kuptimësia ideore e shprehur në gjithë çështjen ekzistenciale të kodit nacional, bëhet objekt i shumë poezive, të cilat konceptohen e formësohen në shkrimin simbolik.

Koha zero e shkrimit

Marrë në spektrin e gjerë, perceptimi bëhet nëse shkrimi i poezisë lexohet përmes një depërtimi në gjuhën e tekstit, që manifestohet kurdoherë nga një shqetësim personal i vënë në shkrim. Shkrimi dhe figura në rrafshin e kuptimit, nuk është i mbyllur përgjatë një komunikim me lexuesin, edhe atëherë kur autori luan me figura e shkronja. Secila poezi sublimohet si ekzistencë në vete në kuptim e përhershëm hapësinor. Esencat e përjetimit të tekstit brenda fantazisë bëhen themelore-jetësore. Historia jetësore-personale, tani në nuancat e detajizuara, shkon nga e tashmja kohore e vetë historisë personale, duke mos iu larguar asnjëherë pësimit individual të përjetuar, për ta kthyer më vonë këtë histori në përshkrim e formim, me një arsyeje të vetme që jeta dhe historia personale të universalizohet dhe jeta të bëhet e pavdekshme: *"Historia e pikës sime"*. Pra, historia ndërtohet e rindërtohet në figurën, duke filluar nga zero, për të ardhur në shkallën e përgjithshme universale përgjatë formimit. Edhe emrat e shënuar dhe loja më ta, njëkohësisht kalimi i tyre në figurë, japin idenë e hapësirës së pavdekshme personale, të një mesazhi artistik e simbolik. E gjithë kjo e bën tekstin poetik, *"MËKATET E E(HA)VËS"* të Musa Ramadanit, me një strukturë shumë shtresore me kontekste të ndryshme shpirtërore-personale, nga koha e tashme autentike, për të kaluar në kohën zero shkrimit e të formimit, çka edhe e kërkon letërsia në funksionin e saj. ■



Një kujtim dhe një me poetin antolo

Azem Shkreli, ky emër i shquar i antologjisë sonë kombëtare, ishte i gjithi para meje, ashtu si e kishte falë Zoti: i pashëm, i thellë, i menduar, porsi një pasqyrë reale e historisë tonë kombëtare.

Intervistoi: Besim R. CENGU

Ishte ditë nëntori e vitit 1996, më saktë data 7 Nëntor. Qendra e Kulturës e qytetit të Kukësit kishte hapur një ekspozitë me punimet më të mira të piktorit të njohur kuksian, Ramazan Memishi. Ato ditë, kjo ekspozitë, u shikua nga shumë dashamirës arti të qytetit tonë dhe të qyteteve tjera. Kishte edhe vizitorë të huaj, që u interesuan për punët shumë të mira të piktorit. Më duket se ishte dita e dytë e ekspozitës, ndërsa në sallonin ku ishin ekspozuar punët, si të ndrojtur, futen dy burra të veshur shik dhe që, në pamjen e parë të jepnin ndjesinë e intelektualëve artistë. Ishte mbrëmje dhe prania e këtyre burrave të panjohur, la tek ne që ishim të pranishëm ndjesi të veçantë. Unë, bashkë me autorin e nderuar të kësaj ekspozite, si me finesë, iu afruam atyre me synimin për t'i njohur më nga afër. U përshëndetëm me ta dhe i treguam se kush ishte autori i tablove. Me një ngrohtësi, që rrallë e kishim takuar ndonjëherë, njëri nga të panjohurit, e vlerësoi ekspozitën përmes një gjuhe shumë profesionale. Theksojmë, se ideja, thellësia dhe teknika, që Ramazan Memishi përdor në punët e tij, mund të interpretohen vetëm nga artistë, që e njohin mirë artin e pikturës. Ne e morëm vesh, se kishim të bënim me një njeri, që është artist me përvojë dhe që interesohet në detaje për gjithçka artistike, që prodhohet tek shqiptarët, dhe si i nxituar e pyeta për emrin. - Quhem Azem Shkreli, - tha ai. -Isha në Tiranë dhe po kthehem për në Kosovë, prej nga jam. Mendova të qëndroj sonte në Kukës dhe të ik nesër.

Azem Shkreli, ky emër i shquar i antologjisë sonë kombëtare, ishte i gjithi para meje, ashtu si e kishte falë zoti: i pashëm, i thellë, i menduar, porsi një pasqyrë reale e historisë tonë kombëtare. Dukej sikur mbante një pjesë të përgjegjësive tona kolektive kombëtare mbi supe, se ishim në periudhën më delikate të qenies tonë të përbashkët. Kosova lëngonte nën thonjtë e pushtuesve serbë, ndërsa ne nën çmendurinë kolektive të piramidave të Sudes. Në atë kohë, unë po filmoja punët e piktorit, dhe për fat, kamera më kishte mbetur mbi sup, ashtu gati për regjistrim. Për një çast m'u kujtuan fjalët e gazetarit të famshëm Italian, Indro Montaneli, kur këshillonte gazetarët, "kudo gazetari duhet të mbajë me vete mjetin e tij, se nuk i dihet, ndoshta rasti e sjell, që në një ashensor, takohesh me ndonjë president a njeri tjetër të shquar, që ia vlen t'ia marrësh dy fjalë". Unë isha gati dhe pa ia bërë të ditur u mundova t'i bëj këtë intervistë të shkurtër.



Azem Shkreli, ju jeni poet i antologjisë së letërsisë shqiptare. Si e gjykoni këtë përcaktim?

Antologjikë janë Naimi, Noli, Mjeda, Fishta, De Rada, Migjeni, gjithë letërsia jonë e traditës është antologjike. Ndoshta ne poetët e sotëm shqiptarë, vlejmë në disa krijime si të tillë.

Pse?

Edhe e sotmja, por dekadat që do të vijnë, do të na vlerësojnë nëse është dikush nga krijuesit si antologjikë, apo jo.

Kadare, Agolli, Podrimja, ju , Din Mehmeti etj, nuk ndjeheni si të tillë?

Di të them, se aktualisht Kadare, Agolli, Podrimja, e të tjerë, janë pasqyrë e epokës shqiptare, interpretë të jetës së këtij kombi ashtu siç është, mësuesit e mëdhenj të shqiptarëve, që kanë aspirata dhe çelin shtigje për të marrë udhë ide përparimtare të cilat aq shumë na duhen sot.

Koha e ndarjes, po thuhet se ka sjellë dy letërsi, një në Shqipëri dhe një në Kosovë. Mendimi juaj?

Ore, më duket se ju po më regjis-

bisedë
ogjik

troni. Ju gazetarët në një farë mënyre jeni edhe "të pabesë"!.

-Po, - pohova sinqerisht.

Mirë pra, po të përgjigjem. Kombi ynë ka një letërsi, se ka vetëm një shpirt. Mund të ketë ndikime, por asnjëherë dy letërsi. Letërsia shqiptare është një dhe vetëm një se shkruhet nga e njëjta gjuhë, përshkohet ngas i njëjti mentalitet, mentaliteti shqiptar, ushqehet nga e njëjta traditë kulturore e formuar që herët. Po një e vërtetë është; ka dy realitete, që kanë ndikuar në krijimtari, por jo thelbësisht. Shembja e murit të vendosur dhunshëm, dy realitetet e krijuara i kthen në një sa ora.

Azem Shkreli ku do të qëndrojë sonte?

Isha në një hotel të qytetit të Kukësit dhe më thanë se duhet të paguaja më shumë se "keni pasaportë të huaj".

Do të jesh mysafiri im i veçantë sonte që të bëhesh jo i huaj, ashtu si edhe je në të vërtetë.

Unë do të fle në hotelin e qytetit tuaj sonte patjetër, që të tregoj se jam i të gjithëve, se kështu jam realisht, jo vetëm unë, por gjithë shqiptarët kudo që janë.

E falënderova poetin e nderuar, duke kujtuar vargjet e tij të mrekullueshme:

Tash jam diku larg teje, larg vedi
dhe - ku me dijtë kah m'tresin
udhëkryqet e shumta t'jetës.

Të nesërmen pimë kafe me të te "Gjalica" dhe iku… Iku dhe unë nuk pata rast ta shoh më Azem Shkrelin, njeriun e vërtetë e poetin brilant, se pas disa muajsh i erdhi papritur shtriga vdekje duke ia "tretë udhëkryqet e shumta t'jetës".

Atë natë do ta ruaj si kujtimin më të mirë për poetin tonë antologjik. ■

Vështrim letrar

Rrëfimi i gjyshes



Fitim VELIU

Poezia 'Rrëfimi i gjyshes' i tekstit poetik të Azem Shkrelit është një kallëzim, që thur në brendësinë e vet historinë dashurore ndërmjet dy të rinjve. Kjo histori rrëfehet si retrospektivë, e cila ndërtohet dhe, po ashtu, rrënohet për shkak të funksionit të kodit kanunor. Historia dashurore ndërmjet dy të rinjve, të cilët shfaqin dashurinë e tyre si ngarkesë emocionale, është dashuri e çastit dhe e momentit. Kjo dashuri shqiptohet si kërkesë emocionale ndërmjet protagonistëve, por këtë dashuri nuk arrijnë ta jetësojnë si dëshirë dhe kërkesë shpirtërore. A. Shkreli këtë rrëfim historie/dashurie e tregon përmes personazhit të gjyshes. Pra, autori, në këtë rast, nuk është dëshmitar i ngjarjes, por është vetëm citues. Kjo dashuri nuk realizohet sepse bëhet pengesë kodi kanunor. Historia e këtij tregimi nga personazhi i tekstit, pra në këtë rast gjyshes, del të jetë fatalitet për jetën e dy të dashuruarve, të cilët i japin fund jetës së tyre për shkak të pamundësisë së realizimit të ëndrrës së tyre dashurore. Djali vetëvritet, ndërsa vasha tretet në dhe të huaj. Historia dashurore e këtyre dy të rinjve shqiptohet nga pozicioni i vetës së tretë 'ata', por vargjet të cilat do t'i ilustrojmë në vazhdim japin një nëntekst të këtij tregimi dashuror, tregim i cili duke pasur statusin kategorial të rrëfimit del të jetë përjetim personal i narratorit: kjo përshkruhet nga vargjet e mëposhtme :

Tha plaka, e hije zije
Si reja i ra mbi sy

Pra, shihet gjendja e rëndë emocionale. Reja si figurë tregon zymtësinë dhe funksionin e saj shkatërrues dhe po ashtu reja personifikon gjendjen e rëndë të protagonistes. Pra, ngjarja e treguar nga goja e gjyshes, del të jetë përjetim personal i vetë gjyshes, edhe pse kjo nuk tregohet si tekst direkt, por nënteksti i saj përmes figurës së resë e bën tekstin të lexohet si situatë personale e vetë narratorit.

Kanë ranun të dy në një fjalë
E të dy n' dashni janë pjekë

Vargu i parë shpreh pajtueshmërinë ndërmjet dy të rinjve për një dashuri reale e cila shqipton zjarrminë e brendshme të dy të dashuruarve. Dashuria në këtë rast shqiptohet si pajtim dhe përjetim i thellë emocional, ku dëshira kalon edhe në konturin e thyerjes së kodit zakonor e moral, por kjo nuk mund të kalohet. Pjekja e tyre në dashuri shkon deri në masë ekstreme, duke e tretur shpirtin dhe trupin fizik të të dashuruarve. Ky ekstremitet bëhet fatalitet, sepse mungon mesi i masës së saj dhe veprimit. Moskonkretizimi i kësaj dashurie vjen si pasojë e ligjit shoqëror që shenjohet në kodin kanunor. Kodi kanunor këtë dashuri reale e emocionale e shndërron në djegie të brendshme së pari shpirtërore, pastaj fizike për ta zhdukur përfundimisht mbarimin e ëndrrës së tyre jetësore. Në vargjet e mëposhtme:

Kanë ra të dy në një fjalë
Po të dy n'dashni janë djegë

Dashuria e këtyre dy të rinjve nuk shqiptohet si kërkesë e përbashkët në fillim, sepse lojën e nis djali si fillim dhe si kërkesë, por aty ku thyhet shpresa e bashkimit të tyre del në pah pajtimi i vashës, por që nuk konkretizohet si rast përfundimtar.

Tash m' dhimbet gjyshja e mjerë
Që vdiq me kanu n'gji......

Këto vargje japin një të vërtetë të pakontestueshme të tekstit, por gjithmonë si nëntekst, ku realiteti i kësaj dashurie del si hierarki. Në fillim narratori, i cili flet për situatën e gjyshes, pastaj gjyshja për situatën e të rinjve dhe, në fund, fjalët e saj jepen në trajtën e mallkimit për kanunin i cili me shekuj nuk bëri lak. ■

Poezi

Në qetësinë e ahishtave

Sadije ALITI

Ikje

Ik nga të gjithë
Je bërë si hije jete
Çka e mban gjallë
Atë iluzion?
Moti ka ndërruar jetë
Bëre traditë varësie
A nuk u besohet dot hijeve
A ekziston me të vërtetë
Pjesë e ditës e natës
E vallëzimit në skenë
E vargut të poezisë
Gjysmën e ngrënies
E zëvendësoi iluzioni
Ç'lidhshmëri!

Pa ardhur

Të ikte ende pa ardhur
Vallë kishte ikje të tilla?
Kishte ardhur më
Nuk ikte nga çmendina
Vazhdonin ikjen
Ende pa ardhur
Fjalë vetëm fjalë.

Imazh i zhgënjyer

Algat shndrisin
Prizës së ujit
Buroi si Drini
Nën ujë e mbi ujë
Thellësi e tepruar
Në qetësinë e ahishtave
Shkëlqimi ruhej me qindra vite.

Lot kristali

Fshehurazi hyre në këngë
Vodhe melodinë
Mos e lër titullin
Vjedhurazi futesh në poezi
Merr strofën e ngatërron vargun
Ik tani nga aroma e lules
Këputet gjethi i trëndafilit
Loti i derdhur mbi petale
Shkëlqen si pikë vese
Mbi tavolinë
Vazoja e kristaltë
E thyer copë-copë.

Paradokse kohe

Kohë në shpirt
Shpirti në kohë
Paradokse,
Shpirti i larë me vesë lulesh
Shkreptimë e agut në prag
Paradokse përvuajtje.

Dëmshpërblim

Pranë i ke të gjitha
Thuaj çke për të thënë,
Mbyll këtë ndodhi
Pyet të tjerë për atë që s'di
Fatkeqësi
S'di njeri për këtë storje
Me personazh pa emër
Vazhdo ndershmërinë
Traumat do të shpërblehen
Vetëm nga Ai mbi qiell.

Në një natë të kthjellët mund të shihen rreth 2000 yje me sy të lirë.



***

Femrat i përpëlitin sytë 2 herë më shumë se meshkujt.

***

Kuajt mund të qëndrojnë deri në 1 muaj në këmbë.

***

Minjtë mund të durojnë pa ujë më tepër se devetë.



Në trupin e njeriut ka rreth 656 muskuj. Disa prej tyre janë 38 cm, e disa mezi arrijnë një milimetër.

***

Gjaku në organizmin e njeriut udhëton shumë shpejtë: prej zemrës deri te gishtërinjtë e këmbës arrin për 16 sekonda, deri në tru për 8 sekonda, deri në mushkëri vetëm për 6 sekonda.

***

Lumi më i gjatë në botë është Nili me gjatësi 6.671 km. që gjendet në Afrikë.





Lumi Amazona është i vetmi lumë që nuk ka të ndërtuar asnjë urë mbi të.

***

Lufta më e shkurtër ka ndodhur në vitin 1898 kur Zanzibari u dorëzua kundër Britanisë vetëm pas 38 minutave, ndërsa lufta më e gjatë zgjati 116 vjet midis Francës dhe Anglisë dhe përfundoi ne vitin 1453.



Mali më i lartë në Kosovë është Gjeravica me 2.656 m. lartësi.


***

Maja e Korabit është maja më e lartë në Shqipëri.

***

Maja më e lartë në botë është Mont Everesti me 8882 m, që gjendet në Nepal.






Vetëm mushkonjat femra pickojnë.

***

Tomas Jang, fizikan i shekullit të XVIII-të fliste dymbëdhjetë gjuhë kur ishte vetëm tetë vjet.

***

Në Brazil gjatë shek. XX-të është vrarë gjarpri më i madh në botë, Anakonda, gjatësia e të cilit arrinte në 35 metra. Për ta vrarë këtë gjigant u desh që të goditej me 500 plumba.



Sulmi i Nato-s kundër Serbisë në vitin 1999 vrau më shumë kafshë se njerëz.

I përgatiti: Ditëlind RESHITI

Zhvillimi gjuhësor i f

Studimet e para identifikojnë ngjarje me rëndësi që ndodhin tek fëmijët në të gjithë globin: të gjithë belbëzojnë rreth 6 muajsh, thonë fjalët e para rreth 1 vjeç, kombinojnë fjalët në fund të vitit të dytë të jetës.



Batjar HALILI

Prindërit me padurim e presin çastin kur fëmija i tyre do të thotë fjalët e para. "Të dëgjosh fjalët 'ma' dhe 'ba' të shqiptuara nga fëmija yt është një emocion që askush nuk mund ta përshkruajë tamam. Mamaja e Anës tregon: 'Kur Ana më tha për herë të parë 'mama' ishte sikur po më përqafonte me krahët e vockla e po më thoshte: Ti je mami im, unë të kamë xhan dhe dua të flas me ty. Do ta kujtoj gjithnjë atë çast'.

Vërtet aftësia për të komunikuar është një dhuratë e çmuar. Gjuha, ose të folurit si diçka specifike e njeriut, i ka magjepsur njerëzit qysh nga kohët më të vjetra.

Teoritë e zhvillimit gjuhësor

Studimet e para identifikojnë ngjarje me rëndësi që ndodhin tek fëmijët në të gjithë globin: të gjithë belbëzojnë rreth 6 muajsh, thonë fjalët e para rreth 1 vjeç, kombinojnë fjalët në fund të vitit të dytë të jetës. Gjithashtu vihet re që fëmijët që kanë lindur të shurdhër ose që janë shpërfillur së tepërmi nuk fitojnë aftësitë komunikuese verbale. Kjo tregon rolin e rëndësishëm të ekspozimit ndaj gjuhës.

Teoritë bihejvjoriste (Skiner)

Sipas kësaj teorie, gjuha si çdo sjellje tjetër është fituar me anë të kushtëzimit operant. Kur fëmija krijon tingujt e parë, prindërit e përforcojnë këtë me buzëqeshje, përqafime e bashkëbisedime. Gjithashtu, imitimi është marrë parasysh nga bihejvioristët për të shpjeguar pse fëmijët mësojnë shpejt fjalë komplekse, fraza e fjali të plota. Imitimi mund të kombinohet me përforcimin për t'u shfaqur gjuha si p.sh.: kur prindërit lajkatojnë: "Thuaj dua biskota" dhe e shpërblejnë fëmijën me diçka, pasi ai përsërit frazën. Pra, përforcimet dhe imitimi kontribuojnë në mësimin e shpejtë të gjuhës. Gjithashtu është vënë re se fëmijët krijojnë fjalë, fjali origjinale e të pazakonta që nuk mund të jenë imituar ose përforcuar nga të tjerët. Kjo sugjeron që në vend të të mësuarit të fjalëve specifike, fëmijët zhvillojnë njohuri të rregullave gramatikore më së miri. Principet bihejvioriste janë të vlefshme për terapitë gjuhësore për të ndihmuar fëmijët me çrregullime serioze gjuhësore për të kapërcyer problemin e tyre.

Teoria e interaksionit

Teoria më e fundit e zhvillimit gjuhësor thekson bashkëveprimin ndërmjet kushteve të brendshme dhe atyre të mjedisit.

Aftësitë personale, një dëshirë e fortë për të bashkëvepruar me të tjerët dhe një mjedis social e gjuhësor i pasur, kombinohen për të ndihmuar fëmijët në zbulimin e funksioneve dhe rregullave të gjuhës. Kompetenca gjuhësore rritet me eksperiencën komunikuese.

Zhvillimi paragjuhësor – marrëdhëniet me të tjerët

Në qëndrimin tonë ndaj njerëzve të tjerë ne priremi që të mbivlerësojmë rëndësinë e gjuhës së folur. Se si ndihemi dhe sillemi ne ndaj njerëzve të tjerë këtë gjë ne e bëjmë të njohur më pak me përmbajtjen konkrete të fjalëve tona se sa me gjuhën e trupit ose me të ashtuquajturin "komunikim joverbal". P.sh ne s'kemi nevojë të themi asnjë fjalë, por mjafton të ngremë lart cepat e buzëve që tjetri të na kuptojë menjëherë: pra i shprehim atij mirësi. Pra mjetet tona të shprehjes në marrëdhëniet tona ndërnjerëzore janë përveç fjalëve të folura edhe trupi, mimika vështrimet, zëri etj.

Tek fjalët e folura, shpesh përmbajtja është më pak e rëndësishme se sa mënyra se si ne themi diçka. Në dy vitet e para të jetës fëmija dhe prindi komunikojnë thuaje vetëm me gjuhën e trupit.

Kur nëna i flet foshnjës së saj, përmbajtja e fjalëve të saj për fëmijën nuk ka rëndësi. Të sapolindurit janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj nivelit të tonit të zërit dhe fjalimet duken më të pëlqyeshme se tingujt e tjerë. Foshnja ia komunikon nënës gjendjen e vetë me anë të motorikes së trupit, mimikës dhe qarjes ose veprimeve. Në ditët e para pas lindjes, foshnja dallon dhe preferon mbi të gjitha tingujt e gjuhës vendase se sa të gjuhëve të huaja. Gjuha e trupit krijon zonat e gjuhës në tru: humanët kanë zona të specializuara në tru që përgjigjen për aftësi gjuhësore. Për shumicën e individëve gjuha është e vendosur në hemisferën e majtë të korteksit.

Në të janë 2 struktura specifike të gjuhës: Zona e Brocasches që njihet si qendra "brocach-iane e të folurit", e cila është e vendosur në lobin frontal dhe kontrollon prodhimin gjuhësor. Dëmtimet në të shkaktojnë çrregullim në komunikim ku personi flet ngadalë dhe pa gramatikë.

Zona tjetër, ajo e Vernick që njihet si qendra "Vernick-iane e të folurit", është e lokalizuar në lobin temporal dhe është përgjegjëse për interpretimin e gjuhës. Kur kjo qendër dëmtohet e folura është e lirshme dhe gramatikore, por përmban shumë fjalë të pakuptimta. Të dy këto qendra lidhen ngushtë me njëra-tjetrën ashtu sikurse lidhen edhe me shumë zona të tjera të trurit. Kur një fëmijë pëson dëmtim të njërës prej qendrave të të folurit p.sh. gjatë ndonjë aksidenti rrugor, truri i tij arrin mjaft mirë që funksionet e të folurit, që ne këtë rast mungojnë, t'i zhvendosë në zona të gjysmës tjetër të trurit. Kur një i rritur humbet të folurën pas një goditje në tru, ripërtëritja ose nuk funksionon fare ose funksionon në mënyrë jo të plotë.

fëmijëve nga 0 - 2 vjeç

Tingujt e parë të folur

Foshnjat janë krijesa të zhurmshme, qajnë, gugatin dhe krijojnë një shumëllojshmëri tingujsh të tjerë që në javën e parë. Pas muajit të parë të jetës, foshnja formon gjithmonë e më shumë tinguj të ndryshëm para së gjithash gugatje si p.sh.: a-a-a-a, o-o-o-o, ose guhr, guhr. Mbizotërojnë zanoret, gradualisht shtohen bashkëtingëlloret. Në muajin e tretë shtohen më shumë tinguj melodiozë si p.sh.: are-are ose agme-agme dhe rreth gjashtë muaj shfaqet belbëzimi, në të cilin foshnja përsërit kombinimet e zanoreve me bashkëtingëlloret në mënyrë të zgjatur si p.sh.: bababa, gl-gl, goo-goo, ose meh-meh. Foshnja gëzohet kur nëna, babai, vëllai apo motrat përsërisin tonet ose tingujt që bën ajo. Kur kërkon të tërheqë vëmendjen ajo fillon të belbëzojë. Pas muajit të pestë belbëzimet bëhen specifike për mjedisin dhe kulturën në të cilën rritet fëmija.

Që belbëzimi të zhvillohet duhet që fëmija të ekspozohet në mjedise ku bisedohet.

Rreth 7 muajsh belbëzimi fillon të përfshijë tingujt e të folurit të gjuhës së të rriturve. Në moshën 8-10 muajsh lindin nga bashkimi i tingujve zinxhirë rrokjesh të tilla si ta-ta, ma-ma, ba-ba. Nga kjo seri tingujsh fëmija merr emrat e parë për prindërit e tij. Nëse formohet së pari fjala "mama" apo "baba" kjo nuk varet nga marrëdhëniet e fëmijës me nënën dhe babain por nga fakti se cilat rrokje është në gjendje fëmija ta shqiptoj të parat.

Të kuptuarit

Në çdo stad të zhvillimit duke përfshirë edhe atë paragjuhësor fëmijët kuptojnë më shumë se sa shprehin. Kur pyesim "ku është mami?" çdo 10 muajsh mund të shohë në drejtim të saj ose kur pyetet "Do që babi të të marrë në krahë?" ai mund të hapë krahët. Gjithashtu, toni i të folurit lehtëson kuptimin e fjalës p.sh.: kur prindërit shohin fëmijën të prekë telin elektrik ata thonë "Mos" mjaftueshëm, ashpër që fëmija të kuptojë rrezikshmërinë e veprimit ose mund ta marrin fëmijën e ta çojnë tek rreziku e të tregojnë me gisht dhe të përsërisin "jo, jo".

Drejt fundit të vitit të parë të jetës, fëmija njeh me emra personat dhe sendet me të cilat ai ndeshet çdo ditë. Ai kupton urdhrat e thjeshta si p.sh.: "Ku është mami?". Kur nëna thotë 'jo' fëmija e ndalon të paktën për një çast aktivitetin e tij.

Ndërmjet moshës 12-18 muajsh, interesi i fëmijës ndaj bisedave rritet. Mirëkuptimi i fëmijës për gjuhën është zhvilluar tashmë aq saqë fjalët kanë një kuptim për të edhe kur personat dhe sendet për të cilët flitet nuk janë të pranishëm. Kur nëna e urdhëron fëmijën të marrë këpucët e tij nga dhoma tjetër atëherë fëmija e di se për cilin send bëhet fjalë dhe se ku ndodhet ai. Në vitin e dytë të jetës fëmija nis të kuptojë fjalë të karakterit hapësinorë që shprehin një sjellje si p.sh.: 'në' ose 'mbi'.

Së pari, fëmija përvetëson kuptimin e parafjalës 'në'. Që nga fundi i vitit të parë të jetës fëmija kupton se një send mund të ndodhët i futur në një send tjetër. Duhet të kalojnë javë dhe muaj derisa fëmija të mund të thotë fjalën 'në'. Shumica e fëmijëve e përdorin këtë fjalë vetëm drejt fundit të vitit të dytë të jetës. Pas fjalëzës "në" vijon fjala "tek". Kur duan që t'i marrë nëna në krah ata thonë 'tek'...

Pra, me parafjalën 'tek' ata kuptojnë një lëvizje në drejtim vertikal. Pas parafjalës 'tek' vijon ajo 'poshtë'. Në vitin e dytë të jetës mirëkuptimi për përemrat 'ti' ose 'jotja' është ende shumë i kufizuar. Një fëmijë dyvjeçar e kupton më mirë urdhrin "jepi babait këpucët" se sa atë "mi jep mua këpucët". Përemrat vetor e mundojnë fëmijën. Prandaj është më mirë që fëmijës t'i flitet me emër dhe jo me 'ti'.

Tipat e fjalëve

Tre janë tipat e fjalëve më të shpeshta në fjalorin e fëmijëve:

- fjalë që shprehin objekte: mollë, zog, mami, qen, kek, libër, top etj
- fjalë që shprehin veprime: ik, më shumë jashtë, pak, lart etj.
- fjalët që shprehin gjendje: u referohen përkatësisë ose kualitetit të gjërave ose ngjarjeve p.sh.: i madh, i pistë, i nxehtë, i bukur, jashtë, e kuqe, të gjithë ikën etj.

Por kemi gjithashtu edhe fjalët personale – sociale: që janë ato që shprehin gjendje emocionale dhe marrëdhënie sociale, si p.sh.: jo, të lutem, dua, faleminderit.

Gjithashtu kemi edhe fjalë të funksionit, fjalë që kanë funksion gramatikor, si p.sh.: për, është, çfarë, në, ku etj.

Zhvillimi i gjuhës së folur (dy vitet e para)


I sapolinduri: komunikim refleksiv – të qara, lëvizje, shprehje fytyre
2 muajsh: Një varg zhurmash kuptimplote – të qara, të qeshura, gugatje, zhurma.
3-6 muajsh: Tinguj të rinj – kërcitje, hungërima, zanore, tinguj
6-10 muajsh: Belbëzim, përfshirë të dy llojet e tingujve, tonet e bashkëtingëlloret të përsëritura në rrokje.
10-12 muajsh: Kuptim i fjalëve të thjeshta: intonacion i thjeshtë; bebet shurdhe shprehin shenjat e tyre të para; bebet që dëgjojnë përdorin gjeste të veçanta si tregimi me gisht për të komunikuar.
13 muajsh: Fjalët e para të folura që janë njohur si pjesë e gjuhës vendase.
13-18 muajsh: Rritje e lehtë e fjalorit me rreth 50 fjali.
18 muajsh: fjalori rritet 3 ose më shumë fjali të mësuara çdo javë.
21 muajsh: Fjalitë e para dyfjalëshe.
24 muajsh: fjali shumëfjalëshe.

Përfundim

Proceset e lindura dhe konteksti social, janë të domosdoshëm për zhvillimin e gjuhës. Humanët janë të destinuar biologjikisht të komunikojnë dhe truri i tyre është i përgatitur për të zhvilluar gjuhën. Në të njëjtën kohë, ndërveprimi verbal ndërmjet të rriturve e foshnjave është thelbësor dhe pa një bashkëbisedues të ndjeshëm dhe komunikues, zhvillimi gjuhësor i fëmijës mund të pengohet. Të dy bashkë, prindi e foshnja, përmbushin atë çfarë as njëri, as tjetri, nuk mund ta bëjnë vetëm: të mësojnë një person të flasë. ■

Depresioni - sëmundje e botës moderne

Organizata Botërore e Shëndetësisë thotë se rreth 6 për qind e burrave dhe pothuajse 10 për qind e grave preken çdo vit nga depresioni. Personat e sëmurë mund të shfaqin shenja të dëshpërimit, pagjumësisë ose të pamundësisë të përfshirjes në jetën e përditshme



Artan N. BEJTA

Lodhja nga intensiteti i ditës, vetmia si pasojë e një kulture moderne gjithnjë e më individuale, lidhjet e dobëta familjare si dhe problemet socio-kulturore, përgatisin një terren të favorshëm për shfaqjen e depresionit në formën e traumave dhe çrregullimeve psikofizike. Problemet e botës mekanike, si dhe krizat shoqërore dhe kulturore të bashkësisë, janë ndër shkaqet e shtimit të depresionit. Sot, për shkak të përhapjes së shumtë të depresionit në shoqëri, ndryshe kjo sëmundje quhet edhe si "Grip Psikik".

Organizata Botërore e Shëndetësisë thotë se rreth 6 për qind e burrave dhe pothuajse 10 për qind e grave preken çdo vit nga depresioni. Personat e sëmurë mund të shfaqin shenja të dëshpërimit, pagjumësisë ose të pamundësisë të përfshirjes në jetën e përditshme.

Çka është depresioni në të vërtetë?

Me depresion kuptohet gjendja e njeriut kur ai kalon një gjendje të vështirë, vuan për një kohë të gjatë dhe jeta i duket e zymtë. Kur njeriu është i depresionuar ai nuk mund të gjejë kënaqësi në asgjë. Njeriu i depresionuar e ka të vështirë të fillojë një punë dhe ai lodhet shpejt. Marrja e vendimeve është në shumicën e rasteve e vështirë, si dhe përqendrimi në mësim ose në lexim. Depresionet dallohen nga pikëllimi ashtu që depresivët janë të paaftë që të gëzohen rreth diçkaje dhe kanë edhe vështirësitë më të mëdha të marrin vendime. Shpesh nuk munden të vendosin më për asgjë dhe qysh në mëngjes nuk dinë se a duhet të ngrihen apo të qëndrojnë të shtrirë. Përderisa depresivët kryesisht nuk mund të vendosin, tek të pikëlluarit vërejmë se, për një kohë të shkurtër pas rastit të pikëllimit, ata mund të marrin vendime befasisht të shpejta dhe të qarta. Një njeri i pikëlluar mundet edhe të argëtohet, ndërsa një njeri i depresionuar rëndë nuk mundet.

Studime të shumta tregojnë se depresioni tek gratë është dy herë më shumë se tek burrat.

Statistikat në Amerikë tregojnë se vetëm për gjatë vitit 2006, depresioni është shënuar si sëmundje e parë në këtë vend, në barnatoret e të cilit janë shitur rreth 60 milionë receta barnash kundër depresionit.

Tek kush paraqitet më shpesh depresioni?

Parvin Shekur, psikolog dhe ekspert klinike, deklaron se depresioni, si një nga çrregullimet më të shumta në sjellje dhe në psikikën e burrave, është diku rreth 12 %, ndërsa kjo shifër është dyfish tek gratë, diku 25 %. Po ashtu, ekspertët deklarojnë se depresioni radhitet, pas infarktit, si shkaktar i vdekjeve tek gratë.

Sot, për shkak të pjesëmarrjes së gruas në aktivitet shoqërore e ekonomike, gruaja ka pësuar një goditje të rëndë. Psikologu Dr. Ghazi, në lidhje me këtë thotë: analizat në mbarë botën tregojnë se femrat pësojnë shumë më lehtë depresion dhe kjo çështje ka lidhje me të gjitha aspektet si: punësimi, marrëdhëniet shoqërore, përgjegjësitë, shqetësimet financiare, mbështetjet psikike dhe shoqërore etj. Dr. Ghazi, është i mendimit se femrat për shkak të ndjeshmërisë së lartë, emocioneve dhe kujdesit që i kushtojnë çdo imtësie, përballen më tepër me entuziazëm dhe ndjenja negative që përfundimisht çojnë në depresion. Ndër faktorët tjerë që çojnë deri tek depresioni i femrave, mund të përmendim edhe streset dhe presionet me të cilët ato përballen jashtë ambientit shtëpiak. Sot për shkak të mungesës së koordinimit midis obligimeve të burrit dhe gruas nga njëra anë dhe punësimit të femrës nga ana tjetër, femrat përballen me probleme të dyfishta psikike.

Shkaktarët e depresionit

Shkencëtarët, gjatë këtyre 50 viteve të fundit, kanë njoftuar se mungesa në tru e një substance me emrin Sertonin,



Organizata Botërore e Shëndetësisë thotë se rreth 6 për qind e burrave dhe pothuajse 10 për qind e grave preken çdo vit nga depresioni.



është një nga shkaqet e paraqitjes së depresionit. Ndërsa psikologët i besojnë faktit se mungesa e përvojave pozitive si: dashuria dhe përkrahja emocionale ndërmjet njerëzve, rezulton me paraqitjen e depresionit.

Depresioni vjen zakonisht në rastet kur kemi të bëjmë me ndryshime të mëdha në jetë. Rastet kur njeriu humbet njerëz të rëndësishëm të jetës së tij, ose gjëra të rëndësishme jetike, si vendin e punës ose banesën, sjellin si rezultat depresionin. Ndonjëherë depresioni vjen dhe në rastet kur njeriut nuk i mjaftojnë energjitë të triumfojë mbi sfida të reja e të mëdha. Të tilla sfida mund të jenë, për shembull, shpërngulja në një vend të ri, përshtatja ndaj një kulture të re ose mësimi i gjuhës së re. Disa njerëz depresionohen më lehtë se të tjerët. Kjo mund të jetë, për shembull, pasojë e faktorëve gjenetikë dhe e karakterit të njeriut. Dihet se me depresionin bashkëlidhen ndryshime në aktivitetin e trurit, ndryshime këto që mbarojnë dhe normalizohen kur depresioni kalon.

Si manifestohet...?

Ai që vuan nga depresioni nuk fle mirë. Zgjimi natën është më se i zakonshëm. Gjumi mund të jetë i lehtë ose me copa. Ndonjëherë me depresionin lidhet dhe të fjeturit e tepërt. Mungesa e oreksit dhe ulja në peshë kanë të bëjnë me depresionin, ndonëse ndonjëherë i depresionuari mund edhe të ketë oreks të tepruar.

Njeriu i depresionuar është në shumicën e rasteve i nervozuar dhe ai mund ta ketë të vështirë të jetë në shoqërinë e të tjerëve. Edhe akuzat e tepruara kundër vetes janë të zakonshme. Gjithashtu, edhe mendimet në lidhje me vdekjen dhe mendimet për vetëvrasje janë të zakonshme për njeriun që vuan nga depresioni. Dhimbje të ndryshme fizike, si dhimbja e kokës, e muskujve, e stomakut e shpinës janë të zakonshme dhe shkaku i tyre nuk gjendet në organizëm.

Jessica Anderson, gjinekologe në SHBA, thotë: "Është e vërtetë se posedimi i një pune të lodhshme në shoqëri dhe koordinimi i saj me punët e shtëpisë është një punë shumë e vështirë për femrat." Ajo shton se 60% e nënave të punësuara në Amerikë, kanë raportuar se stresi dhe presioni psikik është kriza më e madhe dhe më e rrezikshme me të cilën ato përballen.

Si kurohet?

Njeriu duhet të kërkojë ndihmë në rast se vuan nga depresioni për një kohë të gjatë dhe në rast se depresioni pengon në aktivitetet e jetës së përditshme. Për depresionin mund të konsultoheni me infermieren ose mjekun. Është mirë të komunikohet edhe me njerëzit e afërt. Njeriu që vuan nga depresioni akuzon shpeshherë veten për gjendjen e tij dhe kjo ia shton depresionin. Si fillim, shpeshherë është mirë që të qetësohesh dhe t'i japësh kohë vetes të shërohesh. Në të shumtën e rasteve kur je i depresionuar është e vështirë të zgjidhësh probleme të mëdha dhe nëse është e mundur është mirë që zgjidhjen e tyre ta shtysh për më vonë. Shërimi nga depresioni do kohë dhe zakonisht zgjat me javë të tëra, ndonjëherë edhe muaj.

Trajtimi me ilaçe përshpejton shërimin nga depresioni. Ilaçet që përdoren për depresion janë pa rrezik dhe nuk shkaktojnë varësi. Efekti i ilaçeve ndaj gjendjes së përgjithshme dhe simptomave shihet zakonisht pas 2-4 javësh që prej fillimit të kurimit. Trajtimi me ilaçe duhet vazhduar edhe pas shërimit sepse simptomat shfaqen sërish me lehtësi pas ndërprerjes së ilaçeve. Trajtimi me ilaçe zgjat zakonisht 6 muaj dhe gjatë kësaj kohe ilaçet duhen përdorur çdo ditë rregullisht. Për përfundimin e ilaçeve duhet të këshilloheni me mjekun. ■

Autor: ENDRITI	KËNGËTARJA NË FOTO	DËSHIRË OSE POROSI QË LË NJERIU ME FJALËT E FUNDIT PARA VDEKJES	KRYEQYTETI I ITALISË	ALUMIN, AMPER	EMNAK I EMRIT TIDA	KLUB FUTBOLLI SPANJOLL	AI QË I MERRTE FLOKËT FËMIJËS SË PORSALINDUR	MODELJA JONË FEJZULLAI		SUELA (perkdh.)	DESPOTI	EMËR YNI MASHKULLI	PORTIERI SANTIAGO *(Valencia)*	EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN (shq.)
VRAPIMI MË I GJATË NË ATLETIKË									SHKENCA MBI MORALIN					
E LODHUR SHUMË									PORT DETAR					
ISH MISS SHQIPËRIA GENTIANA									FUSHËBETEJA / METODË STUDIMI					
KRYEPROKURORJA E SHQIPËRISË … RAMA				ZANORE	MJET PËR SITJE / FILMI I PARË SHQIP					PUNIM I ARËS / NË RREGUL, MIRË DE				
TIVARI, ELBASANI			LETËR E FORTË NË BIXHOZ / INTER				ISH SEKRETARI I OKB-së KOFI …. / “ASHTU QOFTË”					NJË NGJYRË / SAMIR (perkdh.)		
BABAI				AKTORJA ANGLEZE … FRIEL / PËREMËR VETOR				AKTORJA JONË ISMAILI / “ATAKAMA”						AKTORJA ARVANITASE ….. PAPAS
BASHKËTINGËLLORE		METAL ME SHKËLQIM SI TË ARGJENDIT	ARKEOLOGU SHQIPTAR SKËNDER / I PASUR								DUKATI / SULM, MËSYMJE			
KËNGËTARJA E VJETËR SHQIPTARE ….. TAKE						INDUSTRIAL TECHNOLOGY INSTITUTE / NJËSIM, BASHKIM (sh.shq.)				PARAARDHËS I AMERIKANËVE / NOFKA E Abdurrahman Nokshiqit				
PORTIERI YNË ILION					RRETH I ARIT QË VIHET NË GISHT (sh.shq.) / EMËR MASH. MYSLIMAN (shq.)							ZAIRI, ENDOKIA / “NANTES”		
U ARRATISA NGA BURGU				KYÇ, NYJE / ZANORE			EMRI I BABAIT TË KOMANDANTIT LEGJENDAR TË UÇK-së / RRUGË E HAPUR NËN KODËR						BASHKËTINGËLLORE / PUKA	
E TMERROVE, E ……..									I ZURA ME DORË / DILETANTI					
INTENSITET, LITËR, URANIUM				INSTITUT FRANÇAIS URBANISME / HIT NGA ARDIT GJEBREA				ZANORE / PARA TË NËNTIT						
	AKTORI YNË ZHITOPOTOKU (shq.)	PASTRIM I NAFTËS / ISH FUTBOLLISTI YNË VOKRRI												
ANNA FARIS			PUSULLA / AKTORI HOLLIVUDIAN … LACHEY (shqip.)											
KËNGËTAR I YNI I SHQUAR (Nofka)					SËMUNDJE E TOKËS, EPILEPSI E TOKËS / AKTORI MONTAN (shq.)									
BOTIM							TEFIK OSMANI / ZELANDA, ESTONIA							
SHOK				NËNPUNËSI MË I LARTË NË PERANDORINË OSMANE (pashq.) / FOSFORI										
IRMA LIBOHOVA			GATESË E JONA TRADICIONALE					ISTRES						

